

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“ Inxhinieri Informatike”

i

Institucionit të Arsimin të Lartë “Metropolitan Tirana”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc Olimpjon Shurdi

Prof.Asoc Elson Agastra

Dhjetor 2021

Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 327 Dt. 12.05.2010 MAS Urdhër 197 Dt. 28.05.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.372 23.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 10, datë 07.01.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me insitucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2019-2020: 4 PAE/5 PAK v.a 2020-2021: 5 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2018-2019: 8 studentë v.a 2019-2020: 17 studentë v.a 2020-2021: 23 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Metropolitan Tirana" u licencua me Vendim Nr.357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private të Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana" (Aneksi Nr. 71, VKM e licencimit të UMT). Në zbatim të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë, UMT me Urdhrin nr. 611, datë 28.09.2018 të Ministrit përgjegjës për arsimin ka miratuar statutin e tij, tashmë me statusin si Universiteti "Metropolitan Tirana" (Aneksi Nr. 01, Statuti i UMT). Universiteti "Metropolitan Tirana", me njësitë kryesore të tij është akredituar institucionalisht në Dhjetor 2017, nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5-vjeçare. Pas riorganizimit të UMT si universitet dhe miratimit të statutit të ri, është akredituar, me vendim të Bordit të Akreditimit, Nr.45, datë 05.07.2019 (Aneksi Nr. 62, VBA për akreditimin institucional).

Aktualisht, Universiteti "Metropolitan Tirana" përbëhet nga 3 fakultete dhe secili prej tyre ka në përbërje tre njësi bazë, të organizuara si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

Fakulteti i Ekonomisë, që përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2013-2014 në zbatim të UMASH nr. 197, datë 28.05.2013.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT (FSHKIT) është njësia kryesore e cila ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike". Njësia bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është **Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike** në bashkëpunim me njësitë të tjera akademike si dhe strukturave ndihmës akademike, administrative, të cilat japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ, në funksion të programit të studimit (Aneksi Nr. 39, Organigrama e UMT).

Programi në shqyrtim ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL" dhe akteve nënligjore në funksion të tij.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Masteri i Shkencave në "Inxhinieri Informatike".

Bazuar në Urdhërin nr.48, datë 24.06.2021, "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, për procesin e akreditimit të programeve, Universiteti "Metropolitan Tirana", grupi i vlerësimit përbëhet nga: Prof. Asoc. Olimpjon Shurdi dhe Prof. Asoc. Elson Agastra

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc.Arjana Alija. Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Korrik 2021 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti Metropolitan, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Gjatë vizitës së kryer në UMT, në datën 14-15 Shtator 2021, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Metropolitan Tirana. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr 105/1, datë 18.12.2015 janë:

1. Të krijohet mundësia e pranimit të studentëve cilësor
2. Të përmiresohet niveli i njohurisë së gjuhës angleze
3. Të krijohet mundësia e kualifikimit të stafit akademik
4. Pasurimi i bibliotekës me tituj librash dhe revistash

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Institucioni në vitet e fundit akademike ka bërë përpjekje të tërheq student cilësor, kjo dëshmohet me politikat e rekrutimit që ndjek institucioni, por në dy vitet e fundit akademike nota mesatare është 6.2. Një arsye e mos realizimit cilësor të këtij rekomandimi është edhe arsyeja e largimit të një pjese të studentëve që përfundojnë studimet e ciklit të parë drejt universiteteve perendimore. Gjithashtu, kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi janë shumë të përgjithëshme që nuk garantojnë përzgjedhjen e studentëve cilësor.

GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur pjesërisht.

2. Në vitet e fundit akademike institucioni ka ofruar pedagog të huaj për të dhënë disa lëndë në gjuhën angleze. Gjykojmë se kjo praktik ka shërbyer në rritjen e nivelit të gjuhës angleze të studentëve që tashme e kanë edhe si kërkesë në hyrje të njohjes së një nga 5 gjuhët zyrtare të BE. Te takimi me pedagogët dhe studentët u kostatua që ka përmirësime të kënaqshme në këtë aspekt.

GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

3. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i gjithi me tituj dhe grada, ndërsa për sa i përket stafit akademik efektiv të Departamentit, Fakultetit vërehet se janë bërë përpjekje për ta mbështetur në studime të ciklit doktorat ku disa janë edhe të regjistruar. Me anë të projekteve të fituara është siguruar edhe mundësia për disa pedagog të regjistrohen në sduime doktorate pranë universiteteve të huaja.

GVJ konkludon se ky rekomandimi është përmbushur plotësisht.

4. Referuar vizitës në Bibliotekën e institucionit, u konstatua se një pjesë e literaturës bazë e programit të studimit ndodhej në bibliotekë. Ambjenti ishte modern me arredim tërëqës për të rinjtë, por i limituar në kapacitete, është e domosdoshme zgjerimi i mëtejshëm i ambjentit dhe fondit të librave në bibliotekë. Nga diskutimi me drejtuesit e institucionit na u bë e ditur që në godinën e re të institucionit është parashikuar një ambjent mjaft i bollshëm dhe me fond librash fizik të larmishëm.

GVJ konkludon se ky rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Inxhinieri Informatike”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE.**

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Shënimet e takimeve), GVJ konkludon që programi i studimeve Master i Shkencave (MSH) në “Inxhinieri Informatike” i ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT), në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program bashkëkohor dhe koherent ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studentëve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti. Fusha e programit të studimit është në përputhje me misionin, strategjinë e UMT si dhe strategjisë kombëtare të zhvillimit të teknologjisë së informacionit në vend. Aneksi Nr. 3 Strategjia e zhvillimit të institucionit. Aneksi nr. 61 Të dhëna të përgjithshme mbi programin e studimit.; Shënimet e takimeve
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë e UMT-së. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e Institucionit, strategjinë e zhvillimit të programit të studimit. Parë në tërësi, ky program studimi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit. Aneksi Nr. 1 Statuti UMT; Aneksi Nr.2 Rregullore e Brendshme UMT, Aneksi nr.61 Të dhëna të përgjithshme mbi programin e studimit.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UMT-së dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT si njësi kryesore e tij, të shprehura

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	në strategjinë e zhvillimit të institucionit me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e aplikimit të programeve inxhinierike dhe informatike në përgjithësi dhe të menaxhimit të riskut financiar në veçanti. Në zbatim të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë bazë të këtij programi, Departamentit Financë-Bankë, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë të UMT-së. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve informatike bashkëkohore në fushën e financës.			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi ofron mundësi për të plotësuar tregun e punës në fushën e aplikimit të programeve inxhinierike dhe informatike në fushën e financës dhe sidomos të menaxhimit të riskut në sektorin financiar publik dhe veçanërisht atë privat në nivel kombëtar, por para së gjithash në atë lokal. Vetë niveli i lartë i programit në inxhinieri financiare dhe menaxhim risku bën të mundur koordinimin e nivelit shkencor me atë aplikativ në shërbim të sektorit financiar.			
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Bazuar në përmbajtjen e programit, syllabuset dhe strukturën e tij evidentojmë para së gjithash përmbushjen e standardit shkencor për një program të nivelit të dytë. Niveli dhe struktura e tij është e përshtatshme dhe përligj plotësisht përmbajtjen shkencore të programit ku dominojnë transmetimi i njohurive shkencore në fushën e informatikës inxhinierike dhe financës, të gërshetuar me ato aplikative dhe profesionale. Mbi këtë bazë programi përmbush kriteret për të mundësuar vazhdimin e programit të ciklit të tretë të studimit Doktoraturë në fushat që përfshin ky program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm GVJ kostatoi përmes konsultime me të gjithë dokumentacionin e venë në dispozicion (Statuti, Strategjia, Rregullore etj.) si dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit të UMT-së se program i studimit është ngritur mbi misionet dhe objektivat strategjike të tij të përcaktuara në “Strategjinë e zhvillimit të UMT 2019”

	Aneksi Nr. 3 Strategjia e zhvillimit te institucionit, Aneksi Nr.01 Statuti i UMT			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në dokumentacionin në DVV rezulton se statuti dhe rregullorja e UMT-së përcaktojnë shtyllat kryesore ku mbështetet gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. Rregullore që janë hartuar dhe miratuar në vitin 2013 duke reflektuar edhe ndryshimet ligjore të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë. Në këto akte rregullatore përcaktohen qartë drejtimit prioritar të institucionit, dhe në veçanti ky program studimi ofrohet në përputhje me to. Aneksi Nr.01 Statuti i UMT, Aneksi Nr.2 Rregullore e UMT			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Referuar aktit të hapjes programi i studimit Master i Shkencave (MSH) në “Inxhinieri Informatike” ka kohëzgjatje normale prej 2 vite akademike, 120 ECTS. GVJ, referuar evidencave në dosjen e vetëvlerësimit, konstaton se programi MSH në Inxhinieri Informatike, i cili ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT si njësi kryesore, është në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të UMT dhe specifikisht të njesisë kryesore dhe asaj bazë. GVJ konfirmon që emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij është në përputhje me fushat dhe orientimet akademike të institucionit. DVV, Aneksi 23 Plani mësimor, Aneksi 24 Syllabuset e lëndëve, Aneksi 61 Të dhëna të përgjithshme të programit të studimit.			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Bazuar në DVV, duke analizuar përmbajtjen e programit të studimit rezulton se ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike dhe praktike shkencore por edhe aplikative në fushën e inxhinierisë informatike i shërben zhvillimit të degëve të ndryshme të ekonomisë mjaft të lidhur tashmë me sistemet informatike. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e inxhinierisë informatike nëpërmjet lëndëve si: gjuhë programi të avancuar; machine learning; siguria dhe rrjeta të avancuara etj. Ky program është në përputhje edhe me strategjinë kombëtare të zhvillimit të teknologjive të informacionit. Aneksi 23 Plani mësimor, Aneksi 24 Syllabuset e lëndëve, Aneksi 61 Të dhëna të përgjithshme të programit të studimit.			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi I.3
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Referuar RVB-së, Dosjes së Vetëvlerësimit si dhe protokollit të takimeve gjatë vizitës në vend, GVJ konstaton që programi i studimit MSH në "Inxhinieri Informatike" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e thelluar të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra gjatë zhvillimit të programit të studimit dhe duke mundësuar njohuritë e nevojshme për thellimin e studimeve në ciklin e tretë.</p> <p>Nga të dhënat në dosjen e vetëvlerësimit, konstatohet se nëpërmjet këtij programi studimi synohet që studentëve tu jepet njohuri, dije, aftësi dhe kompetenca të thelluara në fushën e inxhinierisë informatike, sigurisë së informacionit, rrjetave kompjuterike, sistemeve të përpunimit etj. Në përputhje me nivelin 7 të KSHK.</p> <p>Referuar dhe RVB, synohet që programi i studimit të pajisë studentët me aftësitë e nevojshme për të vepruar dhe hulumtuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë sajë, në sajë të njohurive sistematike dhe të integruara në lidhje me zhvillimin e sistemeve informatike të përdorur në këtë fushë.</p> <p>DVV; Shënimet e takimeve; Aneksi 23 Plani mësimor, Aneksi 24 Syllabuset e lëndeve</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në DVV, UMT ka kryer një studim të tregut të punës për fushat ku mund të kenë mundësi të punësohen studentët e këtij programi studimi, ky studim paraqet të dhëna prej vitit 2013 e në vijim. Gjithashtu institucioni para hapjes së programit të studimit ka realizuar një studim të thellë të tregut dhe të degëve të ngjashme aktuale në universitete publike dhe private në vend.</p> <p>Në raportin e përgatitur me të dhënat deri në vitin 2019 del qartë kërkesa e madhe në vend për specialist në fushën e inxhinierisë kompjuterike, të inxhinierisë software dhe të sistemeve digjitale të përpunimit dhe transmetimit të informacionit. Edhe situata e pandemisë në vend dhe botë e ka theksuar më të tej nevojën për inxhinierë të kualifikuar në këto fusha.</p>

	DVV; Shënimeve e takimeve; Aneksi 08 Studimi i tregut të punës
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit, konstatohet që në tërësinë e vet ky program bazohet në objektiva formuese të qarta dhe strukturë të përshtatshme që janë në funksion të dijeve dhe aftësive të studentëve në tregun e punës. Ky program tashmë i përgatitur në kuadër të kërkesave ligjore dhe rregullative me kohëzgjatje 2 vite akademike, arrin ti përgjigjet nevojave të tregut të punës sidomos në zhvillimin e vullshëm që kanë marrë sistemet e informacionit, komunikimit, informatike etj.</p> <p>GVJ bazuar në informacionet dhe gjetjet gjatë takimeve të realizuara në UMT, në analizën për kurrikulën ekzistuese, syllabuset e lëndëve në kategorizimin e tyre A-E, si dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik, ndihmes akademik dhe administrative, të studentëve e ndihmës ashtu edhe të studentëve konstaton se janë arritur objektivat e programit në fjalë.</p> <p>Aneksi 23 Plani mësimor, Aneksi 24 Syllabuset e lëndëve</p>
Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimi mendojmë se ai përafrohet me programe të ngjashme studimi në Universitete homologe të vendeve të tjera që fokusohen në fushën e inxhinierisë Informatike, kryesisht të vendëve perendimore. Përgjatë vizitës në institucion, morëm informacion për referencën e përgatitjes së këtij programi me universitete të huaja që ofronin programe në këtë fushë dhe që UMT ka marrë si model zhvillimi Universitetin Politeknik të Torinos dhe Universitetin e Madridit.</p> <p>Aneksi 23 Plani mësimor, Shënimeve e takimeve</p>
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.	<p>Ky program studimi është hartuar bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Hartimi është fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, në zhvillimin e tij kryesisht me staf efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit MSH në "Inxhinieri Informatike" me 120 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira bashkëkohore.</p> <p>Aneksi 23 Plani mësimor, Aneksi 61 Të dhëna të përgjithshme të programit të studimit.</p>
Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të thelluara teorike/praktike në fushën e inxhinierisë informatike, sistemeve të informacionit, komunikimit etj, duke synuar që të rrisë edhe aftësitë praktike që përfshijnë fushën e mësipërme.</p> <p>Mbështetur në 12 lëndët që ofron programi, por edhe në listën e lëndëve me zgjedhje si dhe praktikën profesionale prej 12 kredite e parashikuar të zhvillohet me rreth 180 orë në institucion, ai arrin</p>

<p>ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin që mbulon këtë program, u theksua rëndësia që i jepet gjatë zhvillimit të shumicës së lëndëve karakteri praktik nëpërmjet sistemeve informatike bashkëkohore dhe që janë tashmë prezentë në shumicën e kompanive dhe institucioneve në vend. Nga verifikimi ynë, praktika profesionale realizohet kryesisht pranë kompanive apo institucioneve me departament IT, gjithashtu universitetit kishte disa marrëveshje në kuadër të programit Erasmus+ të cilat ofronin mundësinë e zhvillimit të praktikës pranë një universiteti të huaj.</p> <p>Bazuar në emërtimin e programit, ky program është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i programit është në përputhje me drejtimin e tij në Inxhinieri Informatike.</p> <p>DVV, Aneksi 23 Plani mësimor, Aneksi 24 Syllabuset e lëndëve</p>			
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Bazuar në DVV, rezulton se disa lëndë zhvillohen nga pedagog të huaj, sikur edhe disa pedagog staf efektiv janë të huaj, kjo është një mundësi shumë e mirë për studentët që të jenë më të njohur me literaturë të huaj dhe të gatshëm për tregun e huaj të punës. Në programin e studimit nuk ka aktualisht student të huaj, por dhënia e lëndëve të veçanta në gjuhë të huaj, jep mundësinë në të ardhmen e realizimit të mobiliteteve nga studentë të universiteteve të huaja pranë institucionit në kuadër të programeve të ndryshme Erasmus+.</p> <p>DVV, Aneksi 23 Plani mësimor, Aneksi 24 Syllabuset e lëndëve</p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Pranë institucionit ruhen dhe arkivohen në gjuhën angleze një pjesë e dokumentacionit të lidhur me programin si: programi i studimit, syllabuset, CV e personelit, marrëveshjet e bashkëpunimit, rregullore të brendshme, etj. Ky informacion ruhet në formë elektronike dhe hardcopy. Ruajtja e dokumentacionit respekton dhe konfidencialitetin e tyre, që është sanksionuar në rregulloret e institucionit.</p> <p>DVV, Aneksi 2 Rregullore e UMT-së, Aneksi 15 Rregullore e sekretarise mesimore, Aneksi 35 Rregullore e Arkivës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UMT ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit MSH në "Inxhinieri Informatike".

Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i i Shkencave Kompjuterike dhe IT, i cili ka tre departamente:

1. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
2. Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
3. Qendra Kërkimore Shkencore.

Burimet njerëzore: Staf i akademik bazuar në CV-të rezultoi me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplina specifike të Inxhinierisë Informatike.

Nga të dhënat që jepen në DVV, rezultoi numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplina specifike të Inxhinierisë Informatike.

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (26 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë (Të dhëna të përpunara nga gjetjet e ASCAL):

1. 4 Prof. Dr,
2. 1 Prof. Assoc,
3. 10 Dr/PhD
4. 11 Msc

Në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike, i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka 9 pedagogë PAE dhe 10 pedagogë PAK (Ref DVV, file TABELAT.pdf Tab 2.1), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Grada, viti akademik 2020-2021	Nr. (ref DVV. Tabelat)
Prof. Dr	2
Prof. Asoc.	0
Dr/PhD	3
Msc	4
Total	9

Bazuar në CV e stafit akademik rezultoi se ai ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë.

Burimet Infrastrukturore: Auditore, Klasa për leksione dhe seminare, Laboratore për praktikë profesionale, Laboratorë

	<p>informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për informimin e studentëve, Zyra për stafin, Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, etj</p> <p>Shërbime IT: (Shërbime Mësimdhënie Edu4school, Google Services, Go toMeeting, Google classroom, MS Teams etj)</p> <p>RVB, DVV, Minutat e takimeve. Tabelat.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Msc në “Inxhinieri Kompjuterike” është program studimi i ciklit të Dytë, që i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit i përket fushës së shkencave inxhinierike, me drejtim specifik në inxhinieri informatike. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT).</p> <p>Departamenti ofron programe studimi në nivelin Bachelor, Master dhe të programeve profesionale jo universitare. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike.</p> <p>DVV, Minutat e takimeve.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të njësisë bazë “Departament i Inxhinierisë Kompjuterike”.</p> <p>Përsa i përket kodifikimit të programeve/klasifikimit, referuar dhe RVB, GVJ është në dijeni të mospasjes në nivel kombëtar të këtij klasifikimi, i cili do të mundësonte përafrimin me ato të direktivave evropiane.</p> <p>DVV, Minutat e takimeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p><i>Nuk përmbushet</i></p>	<p><i>Përmbushet pjesërisht</i></p>	<p><i>Përmbushet kryesisht</i></p>	<p><i>Përmbushet plotësisht</i></p>
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit

të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të këtij programi është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, etj. Ndër funksionet kryesore të Departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve) si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Përgjegjësitë e kësaj njësie bazë si dhe të hallkave të tjera të Fakultetit janë të mirë përcaktuara në rregulloren përkatëse të funksionimit të Departamentit dhe në rregulloren e Fakultetit.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. Vlerësimet e mësipërme u evidentuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>RVB; Aneksi 01 Statuti, Aneksi 02 Rregullore e UMT. Shënimet e takimeve</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UMT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private.</p> <p>Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet me jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja apo me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+.</p> <p>DVV, RVB, Aneksi 56. Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi; Aneksi Nr.57 - Lista e marrëveshjeve Erasmus.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”,</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UMT ka një sërë marrëveshjesh me</p>

<p>institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Kështu, mund të përmendim kompani si CCS, Raiffeisen Bank, Noa sha etj.</p> <p>DVV, RVB, Aneksi 56. Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi; Aneksi Nr.57 - Lista e marrëveshjeve Erasmus.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Referuar Dosjes së vetëvlerësimit DVV, si dhe protokollit të takimeve, GVJ konstaton se UMT ka të përcaktuara qartë modalitetet e kryerjes së praktikës profesionale, përzgjedhjes së kompanisë ku do kryhet ajo, në përputhje me rregulloren për praktikën profesionale, duke siguruar harmonizim dhe larmishmëri në shpërndarjen e studentëve.</p> <p>Ky bashkëpunim bëhet përmes Zyrës e Karrierës dhe Alumni, për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, në bashkëpunim me Deakanin dhe përgjegjësën e departamentit.</p> <p>Megjithatë, institucioni nuk ka një mekanizëm vlerësimi të efektivitetit të bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave mësimore.</p> <p>DVV, RVB, Aneksi 22 Formulari praktikes, Aneksi 54 Rregullore e praktikes mesimore</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, janë të listuara rreth 26 marrëveshje në kuadër të programeve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT, prej të cilave 8 janë marrëveshje me Universitete homologe jashtë vendit (si: Universita degli Studi di Messina, Universita Politecnica delle Marche, Ancona, etj.) që kanë krijuar mundësi shkëmbimi përvoja të stafit akademik të UMT. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u evidentua angazhimi i perbashket në kërkim shkencor si dhe mundësia për përgatitjen e punimit të mikrotezës pranë universiteteve te huaja.</p> <p>DVV, Shënime të takimeve, RVB, Aneksi Tabelat</p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Në dosjen e vetëvlerësimit nuk evidentohet ndonjë raport i hartuar për të analizuar përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Bazuar në RVB, kjo analizë kryej gjatë procesit të intervistimit të studentëve që kishin kryer praktikën pranë institucioneve, kompanive, dhe këto shërbenin për të analizuar përfitimet nga marrëveshjet.</p> <p>DVV, Shënime të takimeve, RVB</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Si një institucion me një historik të programeve të shkencave aplikative (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës) UMT synon të jetë aktiv në fushën e kërkimit shkencor të personelit akademik. Në websitet e institucionit u evidentuan publikimet e bëra nga personeli akademik si dhe veprimtari të tjera lidhur me kërkimet shkencore. DVV, Aneksi 03 Strategjia e zhvillimit të institucionit, Website UMT
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Bazuar në DVV ndjekja e procesit kërkimor shkencor bëhet nga Zv. Dekani për kërkimin shkencor, Zyra e Marrëdhënive me Jashtë dhe Projekteve që mbështet, inkurajon dhe evidenton punën kërkimore të stafit. Raportet vjetore realizohen në nivel departamenti të cilët përpunohen nga zyra e Dekanatit. DVV, Aneksi 03 Strategjia e zhvillimit të institucionit, Website UMT
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Personeli akademik, krahas punës së pavarur kërkimore shkencore, promovohet nëpërmjet përfshirjes në projektet kërkimore të fituara nga institucioni dhe që implementohet nga Zyra e Marrëdhënive me Jashtë dhe Projektet, duke bërë të mundur publikimin e tyre dhe në disa raste mbështetjen financiare. Punime shkencore të personelit akademik janë botuar në revistën shkencore të UMT ("Journal of Business and Economics" me Bord Shkencor dhe me indeks Copernicus) si dhe janë promovuar botime në revista të huaja me faktor impakti. DVV, Aneksi 46 Lista e publikimeve.
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Kopje të punimeve shkencore janë të arkivuara në bibliotekën e UMT dhe në dosjet përkatëse të personelit, të cilat u panë në mënyrë të rastësishme edhe gjatë vizitës në institucion. Në botimet e publikuara në revistën e UMT theksohet pronësia intelektuale e tyre me qëllim minimizimin e plagjiaturave. DVV, RVB
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Institucioni ka angazhuar studentë në projektet ku është partner si dhe në ndihmë të kërkimeve shkencore që realizon personeli akademik, kjo deshmohet në listen e publikimeve, gjithashtu në takimin me studentët u konfirmua një fakt i tillë. Shënime të takimeve Aneksi 46 Lista e publikimeve

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ai ofrohet në 2 vite akademike, 4 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” përmban 120 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar.</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” është niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. <i>Ai synon formimin e shprehive të veçanta në llojshmëri të gjerë në fushën e sistemeve kompjuterike, projektimit, zhvillimit dhe testimit të aplikacioneve software, etj. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që pritet të këtë studenti në</i></p>

	<p><i>përfundim të këtij programi janë sipas nivelit 7 të KSHK (Referuar RVB)</i></p> <p>Bazuar në planin mësimor si edhe në programet e lëndëve (syllabuse të paraqitura) GVJ konstaton se programi i studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” siguron formimin në fushën e sistemeve kompjuterike, sisteme të përpunimit të të dhënave, siguria e informacionit projektimit, zhvillimit dhe testimit të aplikacioneve software</p> <p>RVB; Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Te dhena te pergjithshme per programin</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit duke synuar në thellimin e njohurive me zhvillimet e fundit teknologjike në fushën e inxhinierisë së informacionit. Nga shqyrtimi i syllabuseve vihet re që ka lëndë të avancuara në këtë fushë si: Gjuhë programi e avancuar; Sistemet e avancuar database. Programi ofron edhe lëndë kërkimore me qëllim rritjen e interesit për kërkim më të thelluara akademike dhe shkencore si: Metoda kërkimore, Machine learning.</p> <p>GVJ konstaton se programi ofron njohuri bazë dhe specifike, ndër lidhje të lëndëve teorike me ato aplikative, përgatitje për teknikat e reja, synon plotësimin dhe pajisjen e studentëve me aftësi dhe kapacitete për të zgjidhur problemet që shtron shkenca dhe praktika e inxhinierisë informatike.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ofron njohuri të avancuara në fushën teorike shkencore, por dhe të natyrës aplikative në fushën specifike të inxhinierisë informatike. Këtij qëllimi i shërbejnë trajtimet specifike të gjuhëve moderne të programimit, rrjetave të avancuara dhe siguria. E rëndësishme është që në këtë program arrihet të merren edhe njohuri mbi metodat kërkimore dhe machine learning, të cilat gërshetohen me njohuritë e inxhinierisë informatike që “specializojnë” në një farë mase të diplomuarit në këtë program.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në përputhje me VKM nr.41/2018, lëndët e parashikuara në planin mësimor janë të organizuara sipas kategorive (A-E) me ngarkesën në kredite përkatësisht A, B, C, D, E (Aneksi Nr.23, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).</p>

	<p>Programit i studimit përfshin praktikën profesionale (12 kredite) e cila realizohet në përputhje me rregulloren specifike dhe në bashkëpunim me kompani në fushën kompjuterike. Studenti plotëson raportin e praktikës profesionale, e cila dorëzohet në përfundim të saj tek pedagogu përgjegjës. Zhvillimi i praktikës profesionale monitorohet nga pedagogët përgjegjës të caktuar nga departamenti.</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Pas përfundimit të programit të studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma MSH në “Inxhinieri Informatike”.</p> <p>Aneksi Nr.4 Rregullore e programit MSH në Inxhinieri Informatike; Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E), që kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 9 ECTS (7.5%) - Kategoria Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: 63 ECTS (52.5%) - Kategoria C Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: 18 ECTS (15%) - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 12 ECTS (10%) - Kategoria E (detyrimet përmbyllëse/mbrojtja e temës së diplomës): 18 ECTS (15 %) <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën për përgatitjen e punimit të mikrotezës me 18 kredite me të cilën studentit përmbyllet këtë program duke marrë diplomën “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Informatike”.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit,</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ referuar informacionit në systemin e informacionit të ASCAL, konstaton se UMT është akredituar për herë të parë si institucion sipas VKA Nr. 98, datë 03.11.2015, të Këshillit të Akreditimit dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 45, datë 05.07.2019, të Bordit të Akreditimit, me afat vlefshmërie deri më 14.12.2022. Programi i studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike, është akredituar me Urdhër, Nr. 10, datë 07.01.2016 të MAS. Njësia bazë ofron 6 programe të ndryshme studimi në dy cikle të ndryshme studimi dhe të gjitha programet e studimit janë akredituar ose janë në proces akreditimi nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.</p> <p>Aneksi Nr.62, VBA për Akreditimin Institucional të UMT dhe Certifikata e akreditimit e fundit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT, si njësi kryesore (një nga 3 Fakultetet e Institucionit) dhe Departamenti i Inxhinierise Kompjuterike si njësi bazë që mbulon zhvillimin e këtij programi, përmbushin kriteret ligjore dhe aktet nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>DVV, Tabelat</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT përbëhet nga 2 departamente dhe një Qendër e Kërkimit Shkencor;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike; 2. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; 3. Qendra Kërkimore Shkencore; <p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për PS, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “PhD”.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 48 pedagogë, nga të cilët 26 janë pedagogë efektiv (PAE), dhe 20 pedagogë me kontratë (PAK) .(Lista e stafit të fakultetit)</p> <p>Referuar dokumentit (DVV Tabelat.pdf) stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike që është përgjegjës për</p>

	<p>programin e studimit për tre vitet e fundit akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (7 PAE / 11 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 5 / 9;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (7 PAE/ 10 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 8;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (8 PAE / 9 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 5 / 8;</p> <p>Për sa më sipër FSHKIT përmbush kriteret ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, të gjitha këto në funksion të programit të studimit. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, që ofron programin e studimit MSH në "Inxhinieri Informatike", plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", për sa i përket organizimit dhe strukturën së tij akademike.</p> <p>DVV, Tabelat</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT, si njësia kryesore dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si njësi bazë, me numrin aktual të personelit me kohë të plotë, plotëson detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën ligjore.</p> <p>RVB, DVV, Tabelat.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Për vetë numrin të studentëve të këtij programi studimi ndjekja e praktikës së tyre është bërë nga stafi akademik i programit. Në praktikën e deritanishme, krahas stafit akademik caktohet edhe personel ndihmës në ndjekjen e praktikave të studentëve i cili punësohet sipas nevojave. Do të ishte në interes të këtij programi studimi për numrin e krediteve që ka programi mesimor të parashikohet staf akademik ndihmës me kohë të plotë.</p> <p>RVB, DVV, Tabelat.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinatori i programit, propozohet nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohet nga dekani, është personel akademik me kohë të plotë pranë departamentit. Koordinatorin përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mesimor, në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj.</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale, organizon, planifikon dhe propozon në përputhje me kalendarin akademik orarin mesimor, kalendarin e provimeve etj. Ai informon vazhdimisht drejtuesin e departamentit</p>

	<p>dhe Fakultetit nëpërmjet takimeve verbale. Në bazë të Statutit të Universitetit Metropolitan Tirana, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike pranë Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit MSH në Inxhinieri Informatike, si dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit në fjalë.</p> <p>RVB, Aneksi nr.1 Statuti i UMT, Aneks nr.2 Rregullorja e UMT, Aneksi Nr. 7 – Detyrat e Koordinatorit të studimit</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Nga vizita në institucion evidentuam që Përgjegjësi i Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike monitoron edhe këtë program duke qenë njëkohësisht edhe koordinator i këtij programi, kjo me argumentin e rëndësisë që ka monitorimi i tij në këtë fazë ku jemi në kushtet e pandemise.</p> <p>Minutat e takimeve, DVV</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.3</p> <p>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është njësi bazë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT. Ky departament është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e programit të studimit MSH në Inxhinieri Informatike. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka informacionet për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” si më poshtë:</p> <p>Të dhëna të përgjithshme programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - rregullorja e programit, - plani mësimor; - syllabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese shqip dhe anglisht, - CV e personelit akademik.

	<p>Dokumentacioni i sipërcituar që ruhet, arkivohet dhe menaxhohet nga përgjegjësi i departamentit, dhe gjithashtu, i gjithë informacioni arkivohet edhe pranë zyrës së arkivës.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin; Aneksi 35: Rregullore e arkivës</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar.</p> <p>Programi i studimit MSH në Inxhinieri Informatike është i strukturuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 12 lëndë të ndara sipas 2 viteve (8 lëndë në vitin e parë; 4 lëndë në vitin e dytë. Në vitin e dytë janë parashikuar edhe praktika profesionale me 12 kredite ECTS si dhe punimi i diplomës ose provimi i diplomës me 18 kredite ECTS.</p> <p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit MSH në Inxhinieri Informatike është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>DVV, Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit MSH në Inxhinieri Informatike është i strukturuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 12 lëndë të ndara sipas 2 viteve (8 lëndë në vitin e parë; 4 lëndë në vitin e dytë. Në vitin e dytë janë parashikuar edhe praktika profesionale me 12 kredite ECTS si dhe punimi i diplomës ose provimi i diplomës me 18 kredite ECTS.</p> <p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit MSH në Inxhinieri Informatike është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>DVV, Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit MSH në Inxhinieri Informatike përmban informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Institucioni ka zbatuar një rregull uniform në ndarjen e</p>

<p>auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>orëve në auditor për cdo kredit ECTS. Dhe më konkretisht, për cdo kredit ECTS zhvillohen 10 orë mësimore në auditor, pavarësisht nëse është Leksion, Seminar, Detyrë/Projekt kursi apo Laborator.</p> <p>Mënyra e vlerësimit të dijeve është e përcaktuar në syllabuset e secilës lëndë dhe përfshinë në përqindje të ndryshme kriteret si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitetet didaktike - Pjesëmarrja dhe zhvillimi i laboratoreve - Projekte dhe detyra kursi - Testimet të ndërmjetjme gjatë zhvillimit të lëndës - Provimi përfundimtar <p>Plani mësimor buron nga kurrikula e programit të studimit dhe pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik. Ngarkesa për 1 kredit është 25 orë punë e studentit e ndarë në 10 orë në auditor dhe 15 orë studim individual.</p> <p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtarë, detyrat e kursit, projektet, etj. Plani mësimor përmban të ndarë ngarkesën në orë në auditor/jashtë auditorit: Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 370 orë mësimore - Seminare 230 orë mësimore - Forma te kontrollit te vijueshem ne auditor 140 orë mësimore - Ushtrime/Laboratore 180 orë mësimore - Praktikë profesionale 120 orë mësimore - Provim formimi/punim diplome 180 orë mësimore <p>Total 1200 orë</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen</p>	<p>Studentët, në fillim të secilit semestër, informohen gjerësisht dhe pajisen me programin e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës,</p>

<p>me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar, etj.</p> <p>Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p> <p>Megjithatë duhet të ketë një procedurë më të qartë të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve dhe të gërshtuar ndërmjet rregulloreve të ndryshme që instucionit ka paraqitur. Bazuar edhe në rregulloren e sekretarisë mësimore, në rregulloren e brendëshme të UMT, rregulloren e programit të studimit, vihet re se shumë prej neneve, janë të njëjta mes tyre duke specifikuar të dhëna që nuk janë kompetencë e organeve të cilat këto objekt rregullimi i drejtohen.</p> <p>Sygjerohet që të dhëna dhe kriteret të pranimit, transferimit të studimeve, mendojmë se ato duhet të reflektohen edhe në dokumentat zyrtare të institucionit dhe të ruhen dhe arkivohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p>DVV, Shënime të takimeve</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit MSH. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra; ✓ Numri i krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve (leksione seminare, laboratorë); ✓ Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë); ✓ Mënyra e kontrollit të dijeve të çdo moduli; <p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e mësimnxënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatësisht, studenti vlerësohet, pjesëmarrja në frekuentim, nga detyra e kursit; nga provimi i ndërmjetëm; provimin përfundimtar, në raporte të ndryshme sipas lëndëve.</p> <p>Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me elementët që parashikohen në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar.</p>

	Aneksi Nr.29, Guida e studentit; Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Në planin mësimor është parashikuar një lëndë me zgjedhje, nuk janë paraqitur të gjitha syllabuset e këtyre lëndëve. Emërtimi i këtyre lëndëve është bashkëkohor dhe e përmirëson këtë program studimi. Referuar dosjes së vetëvlerësimit institucioni ka paraqitur ndryshime të planit mësimor në krahasim me atë të licencuar, konkretisht janë ndryshuar 3 lëndë dhe është futur një lëndë e re “Metoda Kërkimore”.			
	Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit paraqitet në programet e lëndëve ai realizohet me një ngarkesë mësimore, shkencore dhe praktike me 120 ECTS dhe me afat kohor dy vite akademike. Shpërndarja e ngarkesës respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me VKM nr.41, Dt. 24.01.2018, i ndryshuar duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, detyre kursi etj. Aneksi Nr.58, Orari mësimor; Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, janë në fushën informatike, sistemeve të përpunimit të informacionit, sigurisë së informacionit duke ju mundësuar studentëve përçimin e njohurive në përputhje me objektivat e programit të studimit. Nga analiza e detajuar e syllabuseve vihet re se disa prej lëndëve kanë nevojë për përmirësimin e përmbajtjes së tyre me njohuri të thelluara sic kanë edhe emërtimin pasi trajtojnë tematika

	<p>relativisht të thjeshta dhe të trajtuara në ciklin e parë të studimeve. Ndër to veçojmë lëndën:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrjeta kompjuterike të avancuara • Sisteme të avancuara të database <p>Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademik ndjek një rrjedhë logjike të trajtimit të argumentave dhe përçimit të njohurive tek studentët.</p> <p>Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thëllon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës kryesisht të sistemeve informatike, zhvillim software etj.</p> <p>Pjesa më e madhe e lëndëve karakterizuese (Tipologjia B) është e shoqëruar më laborator apo pjesë praktike.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë. Lëndë të caktuara, në varësi të specifikave, aplikojnë veprimtari të ndryshme në funksion të mësimdhënies duke respektuar lirinë akademike dhe njëkohësisht për të nxitur studentet të praktikohen më shumë në detyrat e kursit/projekte që zhvillojnë.</p> <p>Programi i studimit MSH në Inxhinieri Informatike, si program i ciklit të dytë, është organizuar sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. dt. 24.01.2018, i ndryshuar. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në orë/kredite) është përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore, duke synuar njëkohësisht për afrimin me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit përfundon me realizimin e praktikës profesionale dhe punimit të diplomës. Nga sa më sipër rezultojnë se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësimin profesional si dhe kërkimin e mëtejshëm shkencor në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre,</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar</p>

<p>ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>nevojat e tregut të punës për specialist në fushat informatike, zhvillimin software, sisteme përpunimi informacioni etj. Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksione/Ushtrime (seminar)/ Projekte/laboratorë/praktika.</p> <p>Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike si dhe studim individual.</p> <p>Gjithsej orë teorike: 370 orë mësimore në auditor (leksione)</p> <p>Gjithsej orë praktike: 530 orë (seminare+ushtrime+projekte)</p> <p>Çka rezulton 370 orë/ 530 orë, ose afërsisht një raport 1:1.4</p> <p>Nga këto të dhëna shohim se studentët realizojnë 1200 orë në auditor, 120 orë për praktiken profesionale dhe 180 orë për punim diplome ose provim formimi (në të dy rastet është studim individual i studentit dhe nuk parashikohen orë mësimore në auditor) dhe 1800 orë studim individual, në total 3000 orë në dy vite akademike në përputhje me standardin ECTS.</p> <p>Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me profilin e zgjedhur që është inxhinieria informatike. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimit të studentit.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit MSH në Inxhinieri Informatike parashikon lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike profesionale. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuritë praktike në tema të ndryshme inxhinierike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një kompani të fushës.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në praktikë në bashkëpunim me ndërmarrje, kompani dhe institucione që operojnë në këtë fushë, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.</p>

	Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të VKM nr. 41, Dt. 24.01.2018, i ndryshuar, Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literatura bazë (e detyrueshme) dhe literature e rekomanduar ndihmëse, në ndonjë rast mungon viti i botimit të literaturës. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet nga drejtuesit e departamenteve të cilët monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Literatura synohet të jetë e viteve të fundit.</p> <p>Megjithatë, vihet re se literatura e përdorur, nuk është cdo herë e viteve të fundit, në veçanti në syllabuse paraqiten literatura të detyrueshme dhe/ose e rekomanduar jo e 5 viteve të fundit disa janë të viteve 2002, 2008, 2009 etj.</p> <p>Aneksi Nr.24, Syllabuset e programit sipas planit mësimor.</p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	<p>Përmbajtja e programit të studimit MSH në Inxhinieri Informatike i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Studenti përvetëson njohuri shkencore, me aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p>Nga analiza e detajuar e syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi, vihet re se në disa prej tyre, argumentat e syllabusit janë në nivelin e ulët Bachelor.</p> <p>Sugjerojmë që disa lëndë të përshtaten më mirë me përmbajtjen e tyre sipas emertimit përkatës të “<i>avancuar</i>”.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.</p>
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit MSH në Inxhinieri Informatike i ofron studentëve njohuri dhe dije specifike të avancuara në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e tretë, doktorat.</p> <p>Aneksi Nr.24, Syllabuset e programit sipas planit mësimor.</p>
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me	Gjatë vizitës në institucionin afirmohet fakti që institucioni realizon anketime periodike me studentët për aktivitetet didaktike, por nuk

<p>kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>realizon një korrelim të pyetjeve mes tyre për të identifikuar, nëse ka, problematika dhe origjinën e tyre.</p> <p>Opinionet dhe mendimet/propozimet e bashkëpunëtorëve apo partnerëve në projekte merren dhe analizohen kryesisht me takime. Nuk vihet re përdorimi i ndonjë procedure të mirë organizuar për të marrë dhe përpunuar të dhëna nga partnerë/bashkëpunëtor jashtë institucionit. Gjithashtu nuk ka një mekanizëm vlerësimi të efektivitetit të bashkëpunimeve të institucionit me palë të treta në kuadër të këtij programi studimi.</p> <p>Propozimet/sugjerimet e palëve të treta merren kryesisht nga takime individuale dhe subjektive. Megjithatë vihet re se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin dhe eksperiencën e duhur për të ndjekur nevojat e tregut dhe përmirësimin e programit të studimit në vijim.</p> <p>Aneksi Nr.34: model pyetësori me studentë, Aneksi 8: Studimi i tregut te punes</p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi është një bazë e mirë lidhur me mundësinë në të ardhmen për studentët e diplomuar për të pasur mundësinë e fillimit të programit të ciklit të tretë të studimit (Doktoraturë) pasi ky program u jep mundësinë e përdorimit të gjuheve të avancuara të programimit, metoda kërkimore dhe sistemeve elektronike, grafike të përpunimit të informacionit, në realizimin e një metodologjie bashkëkohore për punime të doktoraturës.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Plan i mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.5</p>	
<p>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohet në realizimin e</p>	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit MSC në Inxhinieri Informatike ka formimin e duhur akademik për një mësimdhënie konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.</p>

<p>programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit MSH në Inxhinieri Informatike plotëson kërkesat që lidhen me detyrimet ligjore. Konstatohet se departamenti ka angazhuar edhe staf te huaj për përmbushjen e nevojave të programit, si dhe për shkëmbim eksperiencash.</p> <p>DVV, Tabelat.pdf, Aneksi 10 CV e stafit akademik, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.</p>						
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV, referuar dokumentit (<i>Aneks Tabelat.pdf MSH Inxhinieri Informatike Tabelat 12 1-2</i>), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë dy viteve te fundit akademike janë si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 9 pedagogë ndër të cilët 4 PAE dhe 5 PAK.</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 9 pedagogë ndër të cilët 5 PAE dhe 4 PAK.</p> <p>I gjithë personeli akademik i angazhuar në dy vitet e fundit ka minimalisht gradën shkencore Doktor, megjithatë ka pasaktësi përse i përket realizimit të ngarkesës mësimore në tabelat e paraqitura 6.1, 6.2, 7 me tabelat 12.1 dhe 12.2.</p> <p>Duke analizuar realizimin e programit mësimor, bazuar në planin mësimor të paraqitur në tabelën 10 dhe në planin mësimor të lidhur me personelin akademik të paraqitur në tabelat 12.1 dhe 12.2, vërehet kjo përqindje e mbulimit të programit mësimor¹:</p> <table border="1" data-bbox="756 1227 1248 1473"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>57.5 %</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>72.5%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Verehet që institucioni në dy vitet e fundit akademike mbulon me 65 % të ngarkesës mësimore të programit të studimit me personel akademik efektiv PAE.</p> <p><i>-1-referuar realizimit te ngarkeses mesimore, Tabela 12-1 dhe 12-2, duke perfshire oret e praktikes.dhe diplomes (120+180=300 ore) si ore te realizuar nga pedagoget efektiv PAE.</i></p> <p>DVV, Tabelat.pdf, Aneksi 10 CV e stafit akademik, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.</p>	Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE	2019-2020	57.5 %	2020-2021	72.5%
Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE						
2019-2020	57.5 %						
2020-2021	72.5%						
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar në përputhje me objektin apo fokusin e modulit/lëndës</p>						

<p>specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>që zhvillon në program. Kualifikimet e stafit dhe eksperiencia e tyre përputhen me profilin e programit.</p> <p>DVV, Tabelat.pdf, Aneksi 10 CV e stafit akademik</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktikat profesionale zhvillohen në institucionet më të cilat UMT ka marrëveshje të formalizuara ndërinstytucionale dhe drejtohen/mbikëqyren nga pedagogu përgjegjës i caktuar nga departamenti. Ndërkohë në bashkëpunim me institucionet ku do kryhet praktika, caktohet dhe personeli i duhur e i kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale në institucionin e tyre</p> <p>Roli i personelit akademik është i rëndësishëm në bashkëpunimin me këto institucione. Kjo realizohet në përputhje me parashikimet në rregulloren e UMT, Fakultetit dhe të praktikave si dhe në procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.</p> <p>Aneks 56. Lista e kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi; Aneks 22. Formulari i pranimit të praktikës; Aneks 77 Rregullore e praktikave; Aneksi Nr.02 Rregullorja e UMT; Aneksi Nr.17 Rregullore e FSHKIT</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion morëm informacion se institucioni punëson personel ndihmës mësimor e specialistë për realizimin e orëve laboratorike dhe praktikave profesionale dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet.</p> <p>Gjatë orëve të mësimit, pedagogët ndihmohen nga asistentët mësimorë dhe/ose asistentët kërkimorë. Laboratorët e kompjuterave mirëmbahen nga personeli administrativ përkatës nën përgjegjësinë e Zyrës së IT.</p> <p>Megjithatë sic kemi cilësuar edhe në paragrafet e mësipërme në ndihmë të cilësisë sygjerohet të angazhohet personel ndihmës akademik me kohë të plotë.</p> <p>Aneksi Nr.29, Guida e studentit, Aneksi Nr.30 Asetet Infrastrukturore (Të dhëna për infrastrukturën/ kapacitetet), Aneks 70. Lista e laboratoreve në funksion të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Krahas studimit të tregut të punës të vlerësuar më lart, nga vizita në institucion u konstatua që janë bërë përpjekje për të realizuar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës që të mundësojnë studentët që do të diplomohen në këtë program. Anëtare të departamentit në bashkëpunim me zyrën e projekteve kanë realizuar bashkëpunime me qëllim përmirësimin e kurrikulës dhe gjetjen e mundësive me aktorë të ndryshëm për realizimin e projekteve. RVB, Shënime të takimeve								
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe takimin me studentët, u evidentua përfshirja e studentëve në përmirësimet në programin përkatës. Studentët e këtij programi kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me procesin e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve, të shpërndara për ta në fund të semestrit përkatës nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta. RVB, Shënime të takimeve, Vizita nga takimi me studentët								
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët dhe zyrën e karrierës u informuam në lidhje me mënyrën e ruajtjes dhe të gjurmimit të studentëve të diplomuar. Departamenti dhe zyra e karrierës ruanin të dhënat dhe kishin realizuar takime me ish-studentë të diplomuar me të cilët merrnin opinione në lidhje me fushën e punësimit dhe kërkesat e tregut të punës me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Shënime të takimeve								
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Për vetë historikun e këtij programi studimi nuk ka pasur bashkëpunim të tillë me ndonjë institucion kërkimor shkencor publik apo privat. DVV, Shënime të takimeve, Vizita në IAL								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhore të institucionit.	Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat kryesore të tij në funksion edhe të kërkimit shkencor nëpërmjet marrjes së njohurive të thelluara dhe të avancuara në fushën e Inxhinierisë Informatike. DVV, Shënime të takimeve			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga takimi me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike. Bazuar në nivelin dhe nevojat e studentëve, pedagogë të caktuar kanë zhvilluar më shumë mësim aplikativ në laborator me qëllim plotësimin e kuadrit praktik të programit. DVV, Shënime të takimeve			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Për vetë specifikën e programit ai i nxit ata të angazhohen në projekte pasi një numër lëndësh ka karakter aplikativ dhe që bëhet e mundur me infrastrukturën që ofron institucioni. Gjithashtu një rol të rëndësishëm është fakti i pjesëmarrjes në disa projekte me universitete të huaja në të cilat janë angazhuar edhe studentët të programeve të studimit që mbulon Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. DVV, Shënime të takimeve			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Nuk evidentohet ndonjë fakt i tillë, në fokusim në hartimin e politikave të tilla dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare, por referuar rregullores së programit të studimit të departamentit ka prioritet të fuqizoj mardhëniet me institucione homologe dhe të rrisë bashkëpunimet. DVV, Shënime të takimeve			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Në takimin me stafin akademik u afirmua se UMT mbështet punën kërkimore të stafit të Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si njësi që mbulon këtë program. Kjo është realizuar nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS+, mbështetja me botime në revistën e Fakultetit dhe angazhimi në projekte kërkimore që zhvillon UMT në fushën e informatike. Shënime të takimeve			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita pranë institucionit, evidentohet se Institucioni është aktiv në realizimin e projekteve dhe iniciativave shkencore që materializohet me shumë të tilla të fituara në rolin e partnerit dhe në një rast të liderit të projektit. Aktualisht UMT ka në proces zhvillimi disa projekte në të cilat Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka një rol të vecantë pasi është ndër iniciuesit dhe zhvillues i projekteve. DVV, Shënime të takimeve, Aneksi 64 Lista e projekteve.			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Zyra e marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve është aktive në përfshirjen e personelit akademik dhe studentët në realizimin e studimeve dhe analizave të ndryshme. Aktualisht ishin disa projekte në proces implementimi ku janë përfshirë staf akademik dhe studentë. Nga ana tjetër, studentët realizojnë, sidomos gjatë periudhës së praktikës profesionale dhe përgatitjes së mikrotezës, analiza më të thelluara shkencore dhe aplikative. Në këto projekte ishin angazhuar disa student nga ky program. DVV, Shënime të takimeve, Aneksi 64 Lista e projekteve.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Institucioni, gjatë viteve të fundit, ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve promovuese, konferencave shkencore të organizuara në institucion ose jashtë tij, ku pjesëmarrja e studentëve ka qenë e kënaqshme. Bazuar në Raportin e aktivitetit kërkimor shkencor të UMT për periudhën 201-2020 janë organizuar aktivitete shkencore të tilla si: 3 Konferenca Studentore, Simpoziumi shkencor, Konkursi i inovacionit, si dhe tre botime në revistën shkencore të UMT. DVV, Shënime të takimeve, Aneksi 64 Lista e projekteve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit në dosjen e vetëvlerësimit, nuk rezulton që të këtë udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënëse.</p> <p>Vlen të theksohet se si rrjedhojë e kushteve të krijuara nga pandemia Sars-Cov-19, UMT ka reaguar duke realizuar zhvillimin e procesit mësimor në platforma interaktive online. Studentët kanë qenë të pajisur me laptop në momentin e regjistrimit në programin përkatës të studimit.</p> <p>Lidhur me këtë proces, u ofrua trajnimi individual mbi bazë kërkesash dhe udhëzuesish për stafet akademike që të krijojnë forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes të të nxëniet të cilat garantojnë edhe përfshirjen e studenteve në to. Konkretisht, mësimi u zhvillua në platformat GoToMeeting dhe edu4school (platformës menaxhimit të institucionit) në mbështetje të procesit të mësimdhënies për të gjitha lëndët e programeve të studimit që ofron UMT.</p> <p>Institucioni ka miratuar gjithashtu edhe rregulloren përkatëse të mësimin online.</p> <p>Aneksi Nr.37, Ndërfaqe classroom e një pedagogu, Aneksi Nr. 74. Shembuj nga përdorimi i Edu4school dhe gotomeeting.,</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti, janë angazhuar në plotësimin e standardeve cilësore, si dhe zbatojnë rekomandimet e NJSBC. Në rregulloren e UMT-se janë përcaktuar mekanizmat dhe njësitë përgjegjëse për monitorimin.</p> <p>NJSBC është organ kolegjal, që së bashku me përgjegjësit e departamenteve dhe grupe të ndryshme <i>ad-hoc</i> organizojnë kontrollin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Instrumentet e monitorimit të mësimdhënies dhe mësim nxënies janë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për antarët e personelit akademik të kategorisë lektor dhe asistentë lektor nga Përgjegjësi i departamentit dhe Dekani. - Vlerësimi i pedagogut dhe i lëndës nga studentët, që kryhet cdo semestër, duke ruajtur anonimin. - Marrja e opinioneve të studentëve në formë të drejtpërdrejtë nëpërmjet takimeve të zhvilluara nga departamenti/dekanati. - Nëpërmjet qeverisë studentore fakulteti dhe universiteti kanë marrë mendimin e tyre në lidhje me problematika të hasura. <p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga NJSBC në nivel institucional ndërsa në nivel fakulteti, ky proces monitorohet nga njësitë bazë dhe nga Dekanati.</p> <p>Aneksi Nr.05 Rregullorja e NJSBC, Aneksi Nr.62, VBA për Akreditimin Institucional të UMT dhe Certifikata e akreditimit, Aneks nr.14. Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT, përfshin periodikisht studentët në vlerësime periodike e kryesisht të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pyetësorët e studentëve për lëndën dhe pedagogun që kryhen periodikisht me frekuencë semestrale, para zhvillimit të provimit përfundimtar të lëndës.</p> <p>Kontrolli periodik realizuar nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me NJSBC-n për mënyrën e zhvillimit të leksioneve duke asistuar një herë ose dy herë për çdo pedagog dhe duke diskutuar konkluzionet me pedagogët dhe studentët e grupit</p> <p>Procedura përkatëse mbi ankimin e vlerësimin përcaktohet në Rregulloren e provimeve. Verifikimi i vlerësimin bëhet me komision dhe miratohet nga Dekani. Ndryshimet në rezultatit e vlerësimin të studentit bëhet brenda afatit të miratuar të lejueshëm, reflektohet në notën përfundimtare si në sistem ashtu edhe në regjistër. Nga sa më sipër rezulton që institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p> <p>Aneksi Nr.26, Rregullorja e provimeve</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimin.</p>	<p>GVJ konstaton se organi përgjegjës për politikën e cilësisë, është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe njësia në varësi të këtij organi Zyra e Kurrikulës dhe Cilësisë.</p>

	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e UMT janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e NJSBC. Konkretisht hartimi i formularit të anketimit të studentëve bëhet nga NJSBC, e cila pas procesit të përpunimit statistikor nga zyra e IT –së, bën analizën e rezultateve duke evidentuar problematikat dhe rekomandimet përkatëse. Këto raporte analitike ju bëhen të njohura Dekanateve dhe Rektoratit për të marrë masa konkrete. Në përfundim të këtij procesi, masat e planifikuara për përmirësim të mëtejshme ju komunikohen personelit akademik dhe studentëve në takime me to.</p> <p>Aneksi 1 dhe 2: Statuti dhe rregullore e UMT, Aneksi Nr.53 Analiza e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik, Aneksi 55 Raport vjetor i aktiviteti mësimit, kërkimor dhe financiar 2018-2019</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti dhe Departamenti përdor rezultatet e vlerësimeve periodike për të njohur situatën cilësore të programit të studimit dhe për përmirësimin e tij.</p> <p>Konkretisht, gjatë vitit akademik 2020-2021 janë planifikuar dhe zhvilluar seminare/trajnime për mënyrën e zhvillimit të leksioneve, përmirësimin e infrastrukturës mësimore. Institucioni është i përfshirë në projekte ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus+, KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse.</p> <p>DVV, Shënime gjatë takimeve</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p> <p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura</p>	<p>GVJ konstaton se UMT angazhohet që procesi mësimit dhe veprimtaritë e tjera akademike të realizohen në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe duke respektuar lirinë akademike.</p> <p>Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët janë në varësi të llojit/ specifikës së veprimtarive formuese dhe lirisë së veprimit që ka personeli për zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies.</p>

<p>dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Elementët kryesorë të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë: <i>Leksionet, Seminaret, Labororet, Detyrat e kursit, Projektet e kursit, Praktikat mësimore e profesionale, Leksionet e hapura dhe forma të tjera sipas rastit.</i></p> <p>Studentët nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit, njihen me syllabusin e çdo lënde ku janë të evidentuara format e mësimdhënies dhe mënyra e vlerësimit të lëndës, si dhe me materialet didaktike të lëndës të cilat i aksesojnë nëpërmjet sistemit.</p> <p>Disa aktivitete të tjera që mund të jenë më të zgjeruara, organizohen nga departamenti dhe pasqyrohen në planin vjetor të veprimtarisë së departamentit.</p> <p>Syllabusi i secilës lëndë nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu i lëndës. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet Dekanit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT për miratim. Pas miratimit, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike zbaton dhe realizon aktivitetet e planifikuara.</p> <p>DVV, Tabelat :Aneksi Nr.02, Rregullore UMT, Aneksi Nr 17 Rregullore e FSHKIT; Aneksi Nr.4 Rregullore e programit, Aneksi Nr. 23 - Plani mësimor, Aneks Nr. 24 Syllabuset e programit, Aneks Nr.61 Të dhëna të përgjithshme për programin.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon se duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i UMT përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, Gjatë sistuatës të krijuar prej pandemisë Sars-Cov-19, UMT-ja ofroi alternativën online të procesit mësidhënies dhe mësimnxënies (Go To Meeting, edu4schools), sipas specifikave të programeve të studimit apo të lëndëve/disiplinave të planit mësimor. Përdoren tabletat dixhitale dhe software që ndihmojnë dhe lejojnë komunikimin me aktiv. Janë përgatitur udhëzues dhe metoda specifike që të ndihmojnë studimin.</p> <p>NJSBC-ja ka hartuar pyetësorin përkatës për matjen e kënaqësisë së studentit lidhur me alternativën online të zhvillimit të procesit mësimor rezultatet e të cilit janë objekt diskutimi dhe përmirësimi në format e mësidhënies.</p> <p>DVV, Vizita ne institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konstaton se Institucioni rekruton staf akademik të kualifikuar. Gjithashtu, janë organizuar programe trajnimi të strukturuar (seminare dhe workshope lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor, projektet</p>

<p>fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>etj) në nivel Universiteti dhe Fakulteti. Stafi akademik përfshihet në programet e shkëmbimit të stafit me Universitetet e tjera partnere me të cilat ka marrëveshje (Erasmus +).</p> <p>Departamenti i Inxhinierise Komjuterike mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe workshope me Profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme.</p> <p>Aneksi Nr.43, Udhëzues për planin e mobilitetit për stafin akademik në kuader të Erasmus+</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar është i tëri me tituj dhe grada, si dhe me formim profesional në formate kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli akademik transmeton njohuritë dhe konceptet e lëndës të studentit duke konkretizuar ato dhe me raste konkrete të eksperiencave profesionale të tyre. Kjo pasi Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie dhe, se shpërndarja e lëndëve të programit tek stafi akademik realizohet duke u bazuar në fushat e eksperiencës së tyre. Ndihmon këtu edhe angazhimi në projekte të ndryshme, trajnimi i vazhdedhëm etj.</p> <p>Aneksi Nr.10 CV_Personeli Akademik të programit</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga DVV dhe takimi me stafin akademik, studentët e programit, GVJ konstaton se rishikimi i syllabuseve të lëndëve, kryhet çdo fillim viti në UMT, për të gjitha programet e studimit. Për këtë program studimi nuk janë realizuar rishikime të syllabuseve. Drejtuesit e niveleve të ndryshme në Fakultet dhe Universitet si dhe zyrat e shërbimit ndaj studenteve janë në kontakt me shqetësimet e studentëve. Gjithashtu edhe këshilltarët akademikë janë më afër studenteve të secilit grup. Studentet i paraqesin shqetësimet e tyre pranë këshilltarit akademik, ose pranë zyrës së shërbimit ndaj studenteve.</p> <p>Një rrugë tjetër janë edhe pyetësorët. Pyetësori aktivizohet çdo semester. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse të universitetit si një kontribut për përmirësime të mëtejshme. Në vijim ata, ja përcjellin shqetësimin e studenteve organeve eprorë.</p> <p>Stafet akademike ndërthurin shpjegimet në nivel teorik dhe empirik, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis pedagogut dhe studentit.</p>

	DVV, Shënimet te takimeve; Platformat per mesimin online;			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Eksperienca në mësime dhe stafit të programit bën që të përdoren format interaktive duke ndërthurur trajtimin teorik me atë aplikativ. Një zhvillim të mëtejshëm të këtyre metodave e përbën dhe realizimi i mësimit online gjatë situatës pandemike. Shënimet te takimeve; Platformat per mesimin online;			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Personeli akademik përdor detyrat e kursit që prezantohen në grup, kjo i jep mundësi secilit të shprehë idetë e veta, të rrisë shkallën e bashkëpunimit. Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë komunikimin e studentit. Forma të tjera që personeli akademik përdor është marrja e mendimeve të studentëve për aspekte të mësimit. Aneksi Nr.38, Raport për metodat inovative në procesin e mësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit dhe mësimit të aftësisë profesionale, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ konstaton se UMT disponon dy godina në Qytetin Studenti, Rruga "BUDI" dhe "SOTIR KOLEA", të cilat krijojnë mundësinë e zhvillimit të procesit mësimor. Godina qendrore në Rrugën "Sotir Kolea" me sipërfaqe totale 2350 m ² ; Godina në rrugën "Budi" me sipërfaqe 2490 m ² ; Godinat janë të pajisuar me sistem ngrohje totale si në korridore dhe në zyra apo auditore. Auditoret janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal e dinjitoz të të gjithë aktiviteteve didaktike. GVJ rekomandon zgjerimin i hapësirës së bibliotekës së universitetit.

	Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr.30. Asete infrastrukturore akademike _UMT
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	<p>GVJ nga vizita në vend në UMT konstaton se ambientet e dedikuara për procesin mësimor në Godinen 1 dhe Godinen 2, janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC, video projector dhe me internet (wireless).</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se ambienti i bibliotekës ka hapësira të kufizuara dhe të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e institucionit dhe programeve të studimit që ofron. Në veçanti, mungon hapësira në dispozicioni për të shtuar literaturë të re.</p> <p>Biblioteka gjithashtu kishte një numër të ulët të literaturës në dispozicioni. Në bibliotekë ishin sistemuar si literaturë shtesë edhe punimet e diplomave të vet studentëve të këtij institucioni. GVJ mendon se punimet e vet studentëve, edhe pse mund të kenë një përmbajtje cilësore, nuk mund të zëvendësojnë literatura e mirëfillta të publikuara nga shtëpi botuese prestigjioze.</p> <p>Shënime në vizitë, Vizita në IAL</p>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	<p>GVJ konstaton se UMT përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. Ky sistem është implementuar që nga viti 2012, dhe është përditësuar në fillimin e vitit akademik 2020-2021 duke përdorë platformën edu4school. Sistemi mundëson menaxhimin e integruar të të dhënave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Sistemi është një platformë e integruar bazuar në një arkitekturë modulare duke krijuar mundësinë e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave të UMT-së. Sistemi menaxhon në kohë reale lidhjen interaktive student/pedagog, syllabusin e lëndës dhe materialet didaktike të hedhura nga pedagogu (leksione, materiale të ndryshme), frekuentimin e studentit/lëndë, vlerësimet e studentit (vlerësimi i vazhduar dhe ai përfundimtar/lëndë) etj. Studenti në kohë reale ka akses në ecurinë akademike të tij (lista e notave të lëndëve të shlyera, detyrimet akademike të pashlyera etj).</p> <p>Aneksi Nr.26, Rregullore e provimeve; Aneksi Nr.37 Nderfaqe classroom e një pedagogu; edu4School: Sistemi informatik i menaxhimit të studenteve.</p>

<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë akses në literaturën që disponon Fakulteti dhe Universiteti në format fizik, pranë bibliotekës dhe atë online në edu4school.</p> <p>Megjithate, një pjesë e studentëve të këtij programi studimi nuk shfaqnin interes në përdorimin e bibliotekës fizike. Mosnjohja e asetëve të bibliotekës mendojmë se është pasojë e periudhës së shkaktuar nga Covid-19 dhe zhvillimi i aktiviteteve didaktike kryesisht online për këtë brez studentësh.</p> <p>Megjithatë, besojmë se në vitet në vijim, universiteti dhe jeta akademike do të rikthehet sërish në auditorë duke ringjallur edhe kërkesën e përdorimit të bibliotekës. GVJ rekomandon që krahas përdorimit të sistemit edu4school, biblioteka e institucionit të ndërmarrë masa të tilla të cilat do të lehtësojnë e mundësojnë përdorimin e saj masivisht në të ardhmen.</p> <p>Shënime në vizitë, Vizita në IAL</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimit kryesor të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e IAL UMT ndodhet në godinën qendrore të saj dhe ofron shërbimet për të gjithë programet e studimit të ofruara nga institucioni.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua një ambient relativisht i vogël për bibliotekën si për ekspozimin e literaturës në dispozicion, ashtu edhe për akomodimin e studentëve apo stafit akademik që mund ta përdorin. Aktualisht biblioteka nuk mund të akomodojë më shumë se 10 persona njëkohësisht.</p> <p>Literatura në dispozicion në tërësi për bibliotekën vlerësohet e ulët. GVJ nuk ka një informacion të plotë mbi fondin në dispozicion të bibliotekës dhe as për literaturën në funksion të këtij programi studimi. Nga vizita në institucion, dhe në veçanti në ambiente e bibliotekës, në tërësi vihet re një bibliotekë jo shumë e pasur me literature.</p> <p>GVJ sugjeron që institucioni të rrisë fondin e literaturës në bibliotekë sëbashku me kapacitetet e saja akomoduese.</p> <p>Shënime në vizitë, Vizita në IAL</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UMT-ja. Studentët kanë akses të pakufizuar edhe në këto adresa, të cilat janë funksionale për bibliotekën elektronike:</p> <p>www.doaj.org</p> <p>www.gutenberg.org</p> <p>www.freetechbooks.com</p>

	<p>www.thefreelibrary.com</p> <p>Megjithatë, përmbajtja e këtyre bibliotekave elektronike nuk është në përputhje me argumentat e këtij programi studimi apo në cilësinë e duhur për një program të till. Në shumicën e rasteve në këto biblioteka, janë të indeksuar materiale të disponueshme pa pagesë dhe jo gjithmonë të vlerësuar si literaturë e cilësore. Edhe aksesi në to pa pagesë realizohet për literaturë kryesisht të vjetër dhe jo koherente me objektivat e këtij programi studimi.</p> <p>Për qëllimet e këtij programi studimi, dhe evolucionin e shpejtë në teknikat dhe gjuhët e programimit dhe të inxhinierisë informatike duhet që institucioni të garantojë akses në biblioteka që paraqesin literaturë të azhornuar.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Sallat e leksioneve/semnareve janë të pajisuara me PC, projektore. Biblioteka dhe laboratorët e informatikës janë të pajisura PC me programet e nevojshme.</p> <p>Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës.</p> <p>Nga vizita në institucion rezultoi se në funksion të programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike” janë ngritur laboratorët e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori e Informatikës, • Laboratori Multifunksional • Laboratori i Matjeve elektrike dhe elektronike • Laboratori i Autoamtikës dhe FPGA • Laboratori i Komunikimit dhe përpunimit të sinjalit • Laboratori i Informatikës dhe Salla e video konferencës <p>Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike.</p> <p>Aneksi 67. Donacionet nga projektet për laboratorët; Aneksi Nr. 70. Lista e laboratorëve në funksion të programit të studimit</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët janë të pajisur me adresë e-mail në domain @umt.edu.al, adresë që shërben për të aksesuar të gjitha burimet elektronike që institucioni ofron. Gjatë periodhës së</p>

akademik e studentët për përdorimin e tyre.	fundidt, dhe si pasojë e situatës Covid-19, institucioni ka rritur përdorimin e platformave të mësimdhënies online. Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimi edu4school, pedagogët përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT. Nëpërmjet platformës pedagogët ndajnë shënimet dhe materlalet didaktike, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike. UMT, përdor platformën “GotoMeeting” në zhvillimin e procesit mësimor gjatë pandemisë COVID 19.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Studentët dhe stafi përdorin sistemin edu4schools për shpërndarjen e informacionit, ruajtjes së të dhënave, menaxhimit të projekteve apo grupeve të punës. Gjithashtu përdoren platforma GoToMeeting dhe email zyrtar me domain @umt.edu.al.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Përmbyllja e studimeve realizohet me provim formimi ose me mbrojtje të punimit të diplomës për studentët me mesatare mbi 8. Në fillim të semestrit të gjashtë, studentët që kanë të drejtë të mbrojnë diplomën me punim diplome përzgjedhin nga temat e ofruara ose propozojnë vetë një teme. Departamenti aprovon temën dhe i propozon udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës. Pas caktimit të udhëheqesit, studenti dhe anëtari i stafit akademik janë në kontakte periodike (të pakten tre kontrollë të ndërmjetme) gjatë gjithë semestrit, deri në përfundimin e punimit të diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe	Në përputhje me objektivat strategjike të institucionit, UMT përcakton në Statut dhe rregullore prioritetin për sigurimin e cilësisë, si dhe ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjal). NJSBC është organi që bashkërendon veprimtarinë e vet

<p>bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së institucionit dhe në funksion të mësimdhënies.</p> <p>Departamenti Inxhinierisë Kompjuterike ka përcaktuar kordinatorët e programit të cilët, në bashkëpunim me NJSBC, e mbikëqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikëqyrja bëhen edhe nga departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me NJSBC-n. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p>Aneksi Nr.62, VBA për Akreditimin Institucional të UMT dhe Certifikata e akreditimit, Aneksi Nr.03, Plani strategjik i zhvillimit të UMT, Tabela për perberjen Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Aneksi Nr.53, Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit për cilësinë e mësimdhënies midis personelit akademik dhe studentëve. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve përmes një procedurë të plotë në përputhje me rregulloren e vetë universitetit. Duke pasur parasysh që gjuha e mësimdhënies është në gjuhë angleze dhe duke marrë parasysh që fusha kërkon azhurnime të vazhdueshme, departamenti ka punësuar rregullisht pedagogë duke përdorur fushat ndërkombëtare të shpalljes së vendeve të lira të punës. Personeli akademik ka marrë pjesë në leksionet e mbajtur nga aplikantët.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni inkurajon personelin akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie duke u përshtatur me zhvillimet e programit të studimit, me synim që UMT të jetë një institucion novator në fushën e aplikimeve teknologjike.</p> <p>Në përgjithësi, institucioni zhvillon takime të hapura me profesionit të spikatur në fusha të lidhura me ato të ofruara në programet e studimit. Personeli akademik, kur ka qenë e nevojshme, është trajnuar në përdorimin e teknikave dhe instrumentave inovative në funksion të mësimdhënies</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UMT motivon kualifikimin e mëtejshëm të personelit nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve brenda dhe jashtë vendit. Kualifikimi jashtë vendit organizohet nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve, në kuadër të marrëveshjeve që ka lidhur UMT me instucione të arsimit të lartë, organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe të programeve ndërkombëtare si Erasmus+.</p> <p>UMT ofron mbështetje financiare të gjeneruara nga vetë institucioni apo nga projekte ndërkombëtare dhe ka nxitur, mbështetur kualifikimin e stafit akademik të fokusuar në organizimin e</p>

	<p>konferencave/aktiviteteve shkencore programet e shkëmbimit, promovimin e personelit akademik, etj.</p> <p>Megjithatë, institucioni nuk ka një procedurë të standardizuar për vlerësimin e nevojave për mbështetje financiare të stafit në avancimin e tyre akademik dhe shkencor.</p> <p>Aneksi Nr. 64. Lista e projekteve</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni mbështet personelin akademik dhe atë ndihmës akademik duke iu dhënë mundësinë për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor falë bashkëpunimeve me institucione të tjera të arsimit të lartë. Gjithashtu, i motivon në pjesëmarrje në veprimtari jashtë UMT, brenda ekspertizës së shkencave kompjuterike.</p> <p>Aneksi Nr.63, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimit në rrjete, Aneksi Nr. 64. Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit-mobilitetit</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton se në Statut dhe Strategji, institucioni përcakton se personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore të personelit akademik</p> <p>UMT ofron mbështetje institucionale duke vënë në dispozicion të personelit akademik infrastrukturë mbështetëse (laboratore, ambiente, sisteme/ programe informatike, biblioteka etj.</p> <p>GVJ, gjatë takimeve me drejtuesit dhe stafin akademik, konstaton se Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT periodikisht në fund të vitit akademik analizon punën kërkimore dhe mësimore duke evidentuar arritjet dhe mangësitë, si dhe përcakton ecurinë për të ardhmen.</p> <p>Aneksi Nr.02 -Rregullore e UMT, Aneksi Nr.17 -Rregullore e FSHKIT, Aneksi Nr.30 -Asete infrastrukturore akademike _UMT_Tab_Nr.8 Aneksi Nr.55 -Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar i UMT.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>NJSBC dhe Fakulteti vënë në fokusin e tyre metodat e mësimdhënies. Referuar takimeve me stafin akademik dhe NJSBC evidentohet të jenë organizuar seminare, leksione të hapura, konsultime, workshope etj. për metodat e reja, me pjesëmarrjen e të gjithë personelit akademik të UMT.</p>

	Sfidat që solli periudha e pandemisë ishin një shtysë që ndihmoi institucionin në implementimin e metodave inovatore të mësimdhënies. Shenime nga takimet me stafin dhe NJSBC			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë për këtë program dhe vizitës në institucion, u evidentua fakti se institucioni ka miratuar një numër profesorësh të fushës akademike apo personalitete të njohura në organizatat publike dhe private, për të zhvilluar leksione të hapura për tema të veçanta dhe të trajtuara në mënyrë komplekse dhe inovative. DVV, Aneksi Nr.66 -Lista e shkëmbimeve ne kuader te Erasmus +.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Gjithashtu, Senati Akademik ka miratuar një vendim të posaçëm për vlerësimin e vijuar. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare.</p> <p>Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i akesojnë në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 % pjesëmarrja - 5 % aktivizimi - 10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)

	<ul style="list-style-type: none"> - 10 % testimet gjatë vitit - 60 % provimi përfundimtar. <p>Aneksi Nr.24 -Plan programet e lëndëve/syllabuset</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloren e UMT-se dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit që e plotësojnë atë, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lëndë me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezultojnë të jetë realizuar një proces i tillë.</p> <p>Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës.</p> <p>Aneksi Nr.26 -Rregullore e provimeve</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Referuar Rregullores së provimeve, GVJ konstaton se testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), labororet, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet permbyllëse për mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë, por mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës shpërndarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit.</p> <p>Aneksi Nr.26 -Rregullore e provimeve; Aneksi Nr.17 -Rregullore e FSHKIT</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës.</p> <p>Testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Në përgjithësi janë përcaktuar dy testime-kontrolle në javën e katërt dhe javën dymbëdhjetë si dhe një provim i ndërmjetëm (midterm). Studentët testohen me teste, projekte, detyra, etj. sipas syllabusit përkatës</p> <p>Aneksi Nr.28 - Vendimi i Senatit për vlerësimin e vazhduar; Aneksi Nr.27 – Formatet e Syllabuseve, Aneks Nr. -Rregullore e programi. Aneksi Nr.26 -Rregullore e provimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmit, UMT ka vënë në zbatim sistemin elektronik edu4school nëpërmjet të cilit realizohen testime në format quizesh (me alternativa) ose e kombinuar dhe me pyetje të natyrës teorike, të cilat korrigjohen nga pedagogu i lëndës. Provimet zhvillohen me barcode, në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Notat hidhen në mënyrë elektronike në Sistemin Interaktiv edu4school.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësim përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamentet dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, siç parashikohet nga Rregullorja e përgjithëshme e UMT-së, Rregullorja e provimeve.</p> <p>Aneksi Nr.26 -Rregullore e provimeve; Aneksi Nr.69 -Vendim për ngritjen e komisioneve të provimeve</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Kontrolli i testeve dhe provimeve zhvillohet në mënyrë konfidenciale sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e brendshme dhe të provimeve. Vlerësimi i njohurive në mes të vitit dhe në fund të vitit bëhet i koduar në mënyrë anonime. Format e kontrollit parashikohen në rregulloren e provimeve. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Tezat sekretohen nga sekretaria me barkod dhe kontrollohen nga pedagogu në mënyrë anonime. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e provimeve sallat e leksioneve, që janë të pajisura me kamera, për monitorimin e procesit të provimit.</p> <p>Aneksi Nr.26 rregullorja e provimeve, Aneksi Nr.17 -Rregullore e FSHKIT, Aneksi Nr. 2 -Rregullore e UMT</p>

<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të UMT-së. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</p> <p>Aneksi Nr.26 - Rregullore e provimeve; Aneksi Nr.15 - Rregullore e sekretarisë mësimore</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysëm aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike.</p> <p>Çdo antar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontrates së pedagogut dhe Rregullores së Etikës.</p> <p>Aneksi Nr.26 -Rregullore e provimit, Aneksi Nr. 31 -Rregullorja e Etikës -UMT, Aneksi Nr.59 -Rregullore e temës së diplomës</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota më e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi edu4school, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda tre diteve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament.</p> <p>Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quize, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p>Aneksi Nr.26 - Rregullore e provimeve; Aneksi Nr.15 - Rregullore e sekretarisë mësimore; Aneksi Nr.2 -Rregullore e UMT</p>

<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.</p> <p>Mbas kësaj faze, serisht studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të vaçantë.</p> <p>Aneksi Nr.2 -Rregullore e UMT, Aneks Nr.26 -Rregullore e provimeve</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Kërkesa për ankimim note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UMT (refereuar Takimit me stafin akademik).</p> <p>Aneksi Nr.2 -Rregullore e UMT, Aneks Nr.26 -Rregullore e provimeve</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë teorike dhe praktike në fushën e inxhinierisë informatike, praktikën profesionale dhe diplomën. Kjo kurrikul përgatit studentët për thellimin e studimeve në ciklin e tretë doktorat.</p> <p>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse.</p> <p>Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Staf akademik përfshin studentet në veprimtari jashtëkurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studentëve ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e inxhinierisë informatike.</p>

	<p>Studentet përfshihen edhe në veprimtarinë kërkimore të stafit. Ato inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi.</p> <p>UMT ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat mësimore dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, Fakulteti përgjegjës për programin e studimit në vlerësim, po punon për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.</p> <p>Projektet kërkimore kanë në fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Gjatë vitit 2019 -2020, UMT ka aplikuar në 17 projekte të ndryshme dhe është në procesin e implementimit të 6 projeteve të cilat i ka fituar. Në kuadër të projekteve kërkimore dhe mobilitetit JoinEU-SEE III, ERAWEB I, CEEPUS, 14 studentë të FSHKIT kanë realizuar një tremujor studime në universitetet partnere në kushtet e mobilitetit. Gjithashtu kanë realizuar shkëmbime në universitete të huaj në kuadër të programit ersamus+ 5 pedagogë të FSHKIT.</p> <p>Aneksi Nr.24. -Syllabuset. Aneksi Nr. 65 -Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit-mobilitetit Aneksi Nr.66. Lista e shkëmbimeve në kuadër të Erasmus +. Aneksi Nr. 57. Lista e marrëveshjeve Erasmus. Aneksi Nr. 64. Lista e projekteve Aneksi</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Lidhur me këtë kriter, referuar dosjes së plotë të programit të studimit të paraqitur në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se syllabuset e lëndës/modulit paraqesin qartë në përmbajtjen e tyre: ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse, objektivat, aftësitë dhe kompetencat që priten të fitojë studenti. Këto elementë që detajohen në çdo lëndë janë pjesë integrale e objektivave të përgjithshme të programit.</p> <p>Aneks Nr.24 -Syllabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit të studimit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (<i>bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit</i>).</p> <p>Shënime të takimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lëndë/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për</p>	<p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javët e fundit, pedagogët e lëndës informojnë studentët mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në</p>

<p>implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca dhe simpoziume workshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me IAL të tjera iu është krijuar mundësia e mbështetjes konkrete për kërkimin shkencor.</p> <p>Stafi i Departamentit të Inxhinierise Kompjuterike organizon diskutime me studentët për temat e diplomës, për mundësit e punësimit të tyre, u prezanton pjesmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshope me studentët.</p> <p>RVB, Takime, Aneksi Nr. 65 -Lista e universiteteve bashkëpunuese ne kuadër te shkëmbimit/mobilitetit; Aneksi Nr. 38 -Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies; Aneksi Nr. 20 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Studentët e programit MSH në Inxhinieri Informatike kanë në dispozicion laboratorët kompjuterikë, laboratorët te inxhinierisë informatike, si dhe praktikat profesionale. Persa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, Departamenti bashkërendon punën e vet me strukturat e tjera, duke i asistuar ne zhvillimin e praktikave profesionale, gjë që përbën edhe një objeksion gjatë zhvillimit të saj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, labore etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udheheqës apo të lëndës.</p> <p>Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme perben një ndër kompetencat e programit,</p> <p>DVV, Aneksi, 23, 24 , 61, 4.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor në UMT aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile. Në UMT është krijuar dhe funksionon qendra kërkimore</p> <p>Puna me projektet kërkimore në UMT, ka si fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik,</p>

	<p>mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit, si dhe marrjen e përvojave të reja kërkimore.</p> <p>Kështu studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Ne UMT janë krijuar dhe funksionojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Qendra Metroresearch</i> si pjesë integrale e aktivitetit shkencor dhe akademik të UMT, që prezanton standarde të aplikueshme kryesisht në fushën e edukimit, menaxhimit, leadershipit, ndërtimit, TI, zhvillimit të qendrueshëm etj., dhe ofron mentorim, menaxhim apo konsulta për partnerët strategjikë në zhvillimin e projekteve kërkimore. - Metropolitan Incubator (pjesë e Qendrës Metroresearch dhe UMT). Këtu, studentët dhe të rinjtë kanë mundësinë të krijojnë një Start-Up dhe t'i finalizojnë idetë me një produkt përfundimtar. - UMT organizon <i>Konkursin Kombëtar "Start Up City"</i>, (në nivel universitar Shqiperi dhe Kosovë). Sivjet ishte zhvilluar edicioni i tretë. Ne "Start Up City" fituesit përfitojnë një çmim. Start Up City" ndihmon studentët dhe të rinjtë të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit, duke i prezantuar përballe një jurie. <p>DVV, Shenime të takimeve, Takimi me stafin akademik</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni i nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët. Nga ana tjetër GVJ nuk evidentoi që studentë të këtij programi të kishin marrë mbështetje financiare në këtë drejtim.</p> <p>Takimi me studentët</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Në rang institucioni GVJ evidenton forma bashkëpunimi mësimdhënieje me institucione homologe vendase por edhe ndërkombëtare. UMT ka mobilitete shkëmbimi me universitete të huaja. Mobilitetet e realizuara përfshijnë kryesisht shkëmbimet mes stafeve si dhe mobilitete studentësh që kanë studiuar për një periudhë afatshkurtër në universitetet e huaja partnere. Nga studentët e këtij programi nuk ka mobilitete, ndërsa janë realizuar një numër i konsiderueshëm mobilitetesh nga studentë të programeve të tjera që mbulon departamenti.</p>

	DVV, Aneksi Nr.66 - Lista e shkembimeve ne kuader te Erasmus +.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës, përmes një punimi Diplome. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e Institucionit dhe rregulloren e Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani i Fakultetit. Në këtë udhëzues jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të diplomes, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj.</p> <p>Aneksi Nr.02 -Rregullore e UMT, Aneksi Nr.17 -Rregullore e FSHKIT; Aneksi 26 -Rregullore e Provimeve, Aneksi Nr.59 - Rregullore e temes se diplomes.</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e Diplomës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Shënime të takimeve, Aneksi Nr.59 -Rregullore e temës së diplomës.</p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	<p>Procedurat dhe modalitetet e diplomimit ishin përcaktuar në Rregulloren e brendshme të UMT-së, me të cilën studentët ishin njohur në fillim të regjistrimit dhe nga kordinatorët e programit të studimit.</p>

<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Posaçëm i cili në vlerësimin e punimit të diplomes merr si mesatare vlerësimin e çdo anëtari të komisionit.</p> <p>Aneksi Nr.2 -Rregullore e brendshme e UMT-se, Aneksi Nr.59 - Rregullore e temes se diplomes.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të diplomes gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim kjo u kostatua edhe ne takimin me studentet.</p> <p>Aneksi Nr.2 -Rregullore e brendshme e UMT-se, Aneksi Nr.59 - Rregullore e temes se diplomes.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme. Personeli akademik dhe ndihmës asistojnë dhe ndihmojnë studentët e programit MSH ne realizimin e punimit të diplomës</p> <p>Shënime të takimeve, Aneksi Nr.59 -Rregullore e temës së diplomës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, orgjinalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p>RVB, Takimi me studentet dhe pedagogët</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Punimi i diplomes vlerësohet me notë, nga komisioni i posaçëm i mbrojtjes së diplomes i miratuar nga Dekani sipas rregullores së brendshme të UMT-së.</p> <p>Vlerësimi behet në bazë të vlerësimeve të pavarura të anetarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidatit dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të bera nga komisioni. Nota komunikohet në prani të komisionit nga kryetari.</p> <p>Aneksi Nr.2 -Rregullore e brendshme e UMT-se, Aneksi Nr.59 - Rregullore e temes se diplomes.</p>

<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet suplementi. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në sekretarinë mësimore ku procedura ishte konform rregullores së brendshme të UMT-se dhe asaj të menaxhimit të sekretarisë.</p> <p>Shenime të takimeve, Vizita në sekretarinë mësimore.</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.</p> <p>RVB, Shenime të takimeve</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Dokumentacioni i studentit si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas, sipas ligjit për arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike.</p> <p>Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, leshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.</p> <p>Aneksi Nr.35 -Rregullore e Arkives, Aneksi Nr.48 -Shëmbull_Dosje studenti të regjistruar</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>IAL UMT ka në organikën e tijë zyrën e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Zyra ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton Departamenti përkatës, në vijim priten aplikimet, kontrollohen nga personeli përgjegjës dhe procedohen për intervistim. Zyra e BNJ është pjesë e të gjitha hallkave të procesit të rekrutimit dhe ndjekjes së progresit të stafit, duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale.</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore, GVJ konstatoi se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës të angazhuar në programin e studimit. Nga shqyrtimi i dy dosjeve të rastësishme, një për personel efektiv dhe një personel me kontratë, nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion. Po kështu, në dosjet e stafit akademik, ka edhe të dhëna lidhur me kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore dhe akademike, brenda dhe jashtë vendit</p> <p>Aneksi 11. Lista e dokumentacionit për rekrutimin e stafit akademik</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana,</p> <p>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana,</p> <p>Aneksi 75. Procedurat e rekrutimit të stafit akademik,</p> <p>Ngarkesa në Fakultet e stafit akademik;</p> <p>Aneksi 36 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës,</p> <p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm;</p> <p>Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>IAL UMT ka një procedurë të qartë të rekrutimit të stafit akademik si për ata efektiv, ashtu edhe për ata me kontratë. Procedura bazohet në Statutin e Universiteti Metropolitan dhe në rregulloren e tij të brendëshme. Ndjekja e procedurë u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion si nga personeli akademik ashtu edhe nga zyra e burimeve njerëzore si hallkë e rëndësishme e këtij procesi.</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana,</p> <p>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana,</p> <p>Aneksi 75. Procedurat e rekrutimit të stafit akademik,</p> <p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm;</p> <p>Shënimet e vizitave në UMT</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në përgatitjet e fillimit të çdo viti akademik, bazuar edhe në nevojat për plotësimin dhe mbulimin e programit të studimit me personel akademik të kualifikuar, Departamenti përkatës për programin e studimit harton një propozim drejtuar njësisë kryesore. Propozimi përmban të dhënat specifike të lëndës/moduleve/kualifikimeve që kërkohen dhe mënyrën e tyre të vlerësimit.</p> <p>Njoftimi për vende vakante publikohet në faqen web të institucionit sëbashku me kërkesat specifike që kandidatët duhet të plotësojnë. E gjithë procedura ndiqet nga ana e zyrës së burimeve njerëzore sipas rregulloreve institucionale.</p> <p>Aneksi 11. Lista e dokumentacionit për rekrutimin e stafit akademik</p> <p>Aneksi 75. Procedurat e rekrutimit të stafit akademik, RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulit dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Procedura e rekrutimit të stafit akademik është e miratura në UMT dhe bazohet në kërkesën dhe nevojën e departamenteve për të mbuluar me staf akademik të kualifikuar të gjitha aktivitetet didaktike të programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një komision ad-hoc. Megjithatë, në procedurë nuk ka një standard vlerësimi të miratur apo vformat pikëzimi të kriterëve dhe kualifikimeve të kandidatëve. Kjo lihet në dorë të komisionit ad-hoc për të vlerësuar përputhshmërinë e kandidatëve me kërkesat dhe vlerësimin mes kandidatëve nëse ka më shumë se një aplikant.</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti Metropolitan Tirana, ushtron aktivitetin e tij në Qytetin Studenti, Tiranë, Rruga "BUDI" dhe "SOTIR KOLEA". Ambientet e këtij institucioni krijojnë</p>

<p>barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>mundësinë e zhvillimit të procesit mësimor në kushte optimale. Godinat janë të pajisuar me sistem ngrohje totale si në korridore dhe në zyra apo auditore. Auditorët janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal e dinjitoz të të gjithë aktiviteteve didaktike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u has me disa punime infrastrukturore që po zhvilloheshin në institucion për përmirësimin e mëtejshëm të mjediseve në funksion të qëllimit akademik të institucionit.</p> <p>Aneksi 30: Asetet Infrastrukturore të UMT, RVB, Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me përfaqësuesin e departamentit dhe pedagog të këtij institucioni u paraqit një panoramë e angazhimit të institucionit në kualifikimin e vazhdueshëm të stafit.</p> <p>Mbështetja e Institucionit qëndron kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Realizmi i leksioneve të hapura me personalitete nga fushat inxhinierike. - Programet e mobilitetit në kuadër të programeve ndërkombëtare, kryesisht atyre Erasmus+. - Motivimin e stafit akademik pa kualifikimin “Doktor” për zhvillimin e doktoratave në institucione partnere edhe jashtë Shqipërisë (kryesisht me mbështetjen e profesorëve dhe kontakteve personale të tyre). <p>Nuk vihet re mbështetje financiare nga institucioni për stafin akademik për kualifikimin e tyre, dhe pjesëmarrje në botime apo konferenca prestigjioze, edhe pse institucioni aplikon dhe është pjesëmarrës në disa projekte ndërkombëtare.</p> <p>Tabela 6 Cilësia e Stafit Mësimdhënës për PS; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Ka të hartuar edhe një udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit jo vetëm nga stafi akademik, por edhe nga ai administrativ, megjithatë, ky udhëzues është në nivel bazë për përdorimin e infrastrukturës në dispozicion.</p> <p>Në kuadër të situatës së krijuar për të gjithë arsimin e lartë në vend si pasojë e pandemisë Covid-19, ka organizuar, udhëzuar dhe vënë në eficiencë metodat e mësimdhënies në distancë. Në veçanti, stafi akademik është udhëzuar në përdorimin me efikasitet të burimeve elektronike/informatike me anë të platformës GoToMeeting. Stafi akademik dhe ai ndihmës akademik kanë formimin e duhur në përdorimin me efikasitet të ambienteve laboratorike dhe formave të përcjelljes së dijeve nëpërmjet tyre.</p>

	<p>Gjithsesi, nuk rezulton që institucioni të ketë organizuar trajnime specifike në lidhje me kualifikimin e stafit për hartimin dhe shkrimin e projekteve.</p> <p>Edhe pse në aneksin 38 paraqitet që institucioni harton politika inovative të mësimdhënies, kjo nuk është e qartë se si realizohet. Gjatë takimit me stafin akademik, u vu re se një numër shumë i vogël i lëndëve/moduleve zbatonin teknika të mësimit të bazuara mbi projekte.</p> <p>Aneksi Nr. 20 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit; Aneksi 3 Plani strategjik i UMT; Aneksi 51.Politika e cilesise te Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 38 Raport për metodat innovative; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>																																																
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Burimet njerëzore në institucion ndahen logjikisht në staf i angazhuar kryesisht në aktivitete administrative, si sekretaria mësimore, punonjësit e bibliotekës, punonjësit e financës etj, dhe në staf i angazhuar kryesisht në aktivitete akademike dhe ndihmëse akademike.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik, GVJ u informua se stafi akademik gjykonte në një ngarkesë optimale brenda dhe jashtë auditorit duke lenë kohë të mjaftueshme për përmbushjen e të gjithë objektivave brenda institucionit sikurse mund të jetë edhe pjesëmarrja në grupe projektesh.</p> <p>Megjithatë, bazuar në informacionin e paraqitur nga institucioni, në hartimin e RVB-së dhe në veçanti të tabelave sesiore shoqëruese, vihet re një mospërputhje mes tyre. Në veçanti, të dhënat e tabelave 6, tabelës 7 dhe tabelave 12 për vitin akademik 2019-2020 dhe 2020-2021 nuk përkojnë mes tyre.</p> <p>Në tabelën më poshtë paraqitet e përmbledhur analiza nga tre tabelat e sipër përmendura për vitin akademik 2020-2021:</p> <table border="1" data-bbox="576 1464 1383 1883"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit</th> <th colspan="2">Tabela 6.1</th> <th colspan="2">Tabela 7</th> <th colspan="2">Tabela 12.1</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Ne total</td> <td colspan="2">4/6</td> <td colspan="2">4/6</td> <td colspan="2">5/4</td> </tr> </tbody> </table>	Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Tabela 6.1		Tabela 7		Tabela 12.1		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	2	1	0	1	2	1	Prof.Assoc	0	2	1	2	1	1	Dr/PhD	1	1	2	1	2	2	Msc	0	2	1	2	0	0	Ne total	4/6		4/6		5/4	
Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Tabela 6.1		Tabela 7		Tabela 12.1																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr	2	1	0	1	2	1																																											
Prof.Assoc	0	2	1	2	1	1																																											
Dr/PhD	1	1	2	1	2	2																																											
Msc	0	2	1	2	0	0																																											
Ne total	4/6		4/6		5/4																																												

Në mënyrë të ngjashme ka mospërputhje të tabelave edhe për vitin akademik 2019-2020 të paraqitur përkatësisht në tabelta në RVB 6.2, 7 dhe 12.2. E përmbledhur analiza nga tre tabelat e sipër përmendura për vitin akademik 2019-2020 është:

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Tabela 6.2		Tabela 7		Tabela 12.2	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1	1	1	1	1
Prof.Assoc	1	2	1	2	1	1
Dr/PhD	2	2	2	2	2	3
Msc	2	2	2	2	0	0
Në total	6/7		6/7		4/5	

Bazuar në tabelat e më sipërme, eksperiencën e institucionit dhe hapjen e këtij programi studimi që në vitin 2013, GVJ priste të kishte në dispozicion një dokumentacion të saktë dhe koherent.

Nga analiza e tableave të mësipërme në RVB, vëhet re se ka personel akademik të angazhuar në aktivitete didaktike në këtë program studimi (tabela 12), por që nuk është paraqitur në tabelat që përshkruajnë cilësinë e stafit akademik për këtë program studimi (tabelat 6), të cilat gjithashtu nuk përkojnë as me të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për program studimi (tabela 7). Të dhëna që për nga ana sasiore nuk përkojnë as me numrin total të stafit akademik të paraqitur në tabelat 8 për stafin akademik të ndarë sipas moshës.

Gjatë vizitës në institucion, nga ana e GVJ ju bë e ditur institucionit për këto mos përputhje dhe Ju kërkua të vinin në dispozicion dokumentacion shtesë për të vlerësuar ngarkesën efektive të stafit akademik.

Institucioni, më datë 17.09.2021 ka dorëzuar në ASCAL dokumentacion shtesë si "Dërgohen Evidencat shtesë në kuadër të riakreditimit të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike pranë Universitetit "Metropolitan Tirana"".

Gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni shtesë që paraqet "Ngarkesa sipas planit mësimor në programet studimore të FSHKIT për vitin akademik 2020-2021", GVJ vëren se ka mospërputhje mes këtij materiali dhe atyre të paraqitura në RVB.

Në veçanti, nëse krahasojmë të dhënat e dokumentit shtesë me ato të paraqitura në tabelën 12.1 në RVB, që paraqet planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës, vërejmë se:

- Paraqitet personel akademik që angazhohet në mësimëdhënie në këtë program studimi (dokumentacioni shtesë) por që nuk figuron në tabelën 12.1
- Orët e ngarkesës mësimore në auditor për personelin akademik për lëndë të këtij programi studimi (për personelin që paraqitet tek të dy dokumentat) nuk përputhen mes tyre duke ndryshuar ngarkesën në orë në auditor edhe me 50%

Nëse krahasojmë dokumentin shtesë me të dhënat në tabelën 4.1 vërejmë gjithashtu që ka mospërputhje si:

- Paraqitet personel akademik i angazhuar në këtë program studimi por që nuk figuron në tabelën 4.1
- Orët e ngarkesës mësimore në auditor për personelin akademik për lëndë të këtij programi studimi (për personelin që paraqitet tek të dy dokumentat) nuk përputhen mes tyre duke ndryshuar ngarkesën në orë në auditor edhe me 50%

Gjithashtu, ka mospërputhje edhe mes tabelave 4.1 dhe 12.1 përkatësisht për “Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike në një vit akademik (tab. 4.1)” dhe “Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (tab.12.1)”.

- Në tabelën 4.1 paraqiten personel akademik që nuk figuron në tabelën 12.1
- Në tabelën 14.1 nuk paraqiten stafi i angazhuar në disa prej lëndëve që janë pjesë e këtij programi studimi sipas tabelës 12.1
- Ngarkesa në orë mësimore për angazhimin në këtë program studimi nuk përputhen mes dy tabelave.

Pa i detajuar të gjitha mospërputhjet në dokumentacionin e paraqitur, sugjerojmë institucionin që të hartojë në mënyrë të saktë dhe të mbajë të azhurnuar dokumentacionin në lidhje me programin e studimit të kërkuar për vlerësimin e cilësisë së tij.

Institucioni të paraqesë të saktë dhe në përputhje me realitetin të dhënat sasiore për të vlerësuar përmbushjen e kritereve dhe standardeve të cilësisë.

Paraqitja e tyre të plota dhe të sakta ndihmojnë institucionin për të vlerësuar me objektivitet pikët e dobëta dhe pikët e forta dhe

	për përmirësime në vazhdim si institucioni por edhe si ofertë akademike dhe përçim të dijeve tek studentët.			
	RVB; Shënimet e vizitave në UMT, Shtojca 09. dokumenti i licensimit të programit të studimit Tabelat në RVB; Dokumentacioni shtesë i përcjellë mbas vizitës në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se IAL UMT siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Aktiviteti didakti shtrihet në dy godina në Qytetin Studenti, Tiranë, Rruga “BUDI” dhe “SOTIR KOLEA” me sipërfaqe totale përkatësisht 2347 m ² dhe 2490 m ² . GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe në veçanti në ambientet e tij, vlerësoi se ato kanë kushte të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve didaktike të parashikuara. Megjithatë, GVJ nuk ka të dhëna të plota në lidhje me shfrytëzimin e këtyre ambienteve edhe nga programet e tjera të studimit të ofruara nga institucioni. Besojmë se ky kriter vlerësohet në tërësi gjatë akreditimit institucional dhe jo atij të një programi studimi. Edhe gjatë takimit me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u vu në dukje që ambientet e institucionit janë të bollshme për të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni dhe ky parametër në tërësi është vlerësuar gjatë akreditimit institucional. Aneksi 30 Asetet Infrastrukturore akademike, tabela për Numrin e studentve të regjistruar për here të pare; RVB; Shënimet e vizitave në UMT;
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik,	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në sallat laboratorike tek të cilat zhvillohet aktiviteti laboratorik me ndihmën e kompjuterëve, ishin të instaluar software profesionalë, projektor etj. të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Aneksi 38 Raporti mbi metodat innovative në procesin e mësimdhënjes, aneksi 73, RVB, Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar në natyrën specifike të programit të studimit, laboratorët e kërkuar duhet të jenë me pajisje kompjuterike dhe softwer profesional në funksion të përcimit të njohurive specifike.</p> <p>Nga vizita në institucione dhe në veçanti në ambientet laboratorike vihet re pajisja me kompjuter me parametra teknike të mjaftushme për zhvillimin e aktiviteteve laboratorike për këtë program studimi dhe gjithashtu prania e moduleve dhe kompilatorëve të gjuhëve të programimit të analizuara dhe përdorur në lëndë të këtij program studimi.</p> <p>DVV; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vizitoi laboratorët e dedikuar të programit Master i Shkencave Inxhinieri Informatike dhe konstatoi që ato ishin të pajisur me kompjutera të përshtatshëm dhe kishin të instaluar programe profesionale të lidhura me përdorimin e teknologjive bashkëkohore të fushës së kompjuterave.</p> <p>Nga vizita në institucion, na u konfirmua se laboratorët mund të aksesohen nga studentët edhe përtej orarit didaktik të lëndëve përkatëse dhe ti përdorin ato për punimin e detyrave/projekteve të kursit.</p> <p>Aneksi 30: Asetet Infrastrukturore akademike, Aneksi 70 Lista e laboratoreve ne funksion te programit te studimit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon.</p> <p>Aneksi 30: Asetet Infrastrukturore akademike, Aneksi 70 Lista e laboratoreve ne funksion te programit te studimit; Aneksi 63. Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te studimit Aneksi 56. Lista e kompanive me te cilat institucioni ka marreveshje bashkepunimi RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm, vizitoi ambientet e “Universitetit Metropolitan Tirana” dhe në veçanti ambientet e bibliotekës. Gjatë kësaj vizite, por edhe nga takimi me studentët dhe stafin akademik, u vu re se biblioteka mund të përdoret nga të gjithë studentët dhe stafi akademik në mënyrë të barabartë pa pagesë. Në bibliotekë gjendeshin edhe disa PC që lejonin aksesin e literaturës në format elektronik.</p> <p>Megjithatë, mendojmë se biblioteka nuk ka hapësirën e mjaftueshme në funksion të të gjithë programeve të studimit të ofruara nga institucioni. Gjithashtu fondi i librave në dispozicion është i kufizuar dhe jo i azhurnuar në funksion të këtij programi studimi.</p> <p>Literatura në dispozicion në bibliotekë është relativisht e ulët, dhe në të janë afishuar edhe punime të vetë studentëve si diploma apo materiale të tjera studimore.</p> <p>Pa paragjykuar cilësinë e punimeve të diplomave të studentëve, të cilat mendojmë se kanë një përmbajtje cilësore, ato nuk mund të zëvendësojnë kursesi një literaturë të mirëfilltë të publikuar nga shtëpi botuese prestigjioze.</p> <p>Aneksi Nr.30, Asetet Infrastrukturore, akademike UMT; Shtojca 2 - Titujt e librave RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha</p>	<p>Ky program studimi është në nivel Master, dhe literatura në gjuhë të huaj nuk përbën pengesë për përcimin e dijeve tek studentët.</p> <p>Megjithatë, edhe nga vizita në bibliotekë, edhe nga dokumentacioni shtesë i kërkuar gjatë vizitës në institucion në lidhje me literaturën në funksion të këtij programi studimi, dhe i ofruar si “Shtojca 2” nga institucioni, vërejmë se literatura nuk</p>

<p>moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>është e azhornuar në 5 vitet e fundit. Në disa raste ajo është më e vjetër se 10 apo 12 vite. Kjo e parë edhe nga literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar në syllabuset e lëndëve.</p> <p>Megjithatë, bazuar në objektivat e këtij programi studimi dhe zhvillimet e vullshme në këtë fushë, GVJ mendon se është detyrë dhe përgjegjësi e institucionit të mbështesë me literaturë të azhornuar bibliotekën.</p> <p>Shtojca 2 - Titujt e librave</p> <p>Anex. 24. Silabuset e Lendeve</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan Tirana ofron platformën “edu4school”. Nëpërmjet këtij aplikacioni studentit i mundësohet akses në leksione dhe materialet e ndryshme didaktike që janë në përputhje me syllabuset lëndore të Universitetit. Studentet konsultohen me leksionet në kohë reale. Ata kanë akses edhe në adresa online të cilat shfrytëzohen si biblioteka elektronike të tilla si:</p> <p>www.doaj.org</p> <p>www.gutenberg.org</p> <p>www.freetechbooks.com</p> <p>www.thefreelibrary.com</p> <p>Megjithatë, përmbajtja e këtyre bibliotekave elektronike nuk është në përputhje me argumentat e këtij programi studimi apo në cilësinë e duhur për një program të tillë. Në shumicën e rasteve në këto biblioteka, janë të indeksuar materiale të disponueshme pa pagesë dhe jo gjithmonë të vlerësuara si literaturë cilësore. Edhe akses në to pa pagesë e realizohet për literaturë kryesisht të vjetër dhe jo koherente me objektivat e këtij programi studimi.</p> <p>Për qëllimet e këtij programi studimi, dhe evolucionin e shpejtë në teknikat dhe gjuhët e programimit dhe të inxhinierisë së informatike, duhet që institucioni të garantojë akses në biblioteka që paraqesin literaturë të azhornuar dhe në funksion të këtij programi studimi.</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstatoi që ajo ishte e pajisur me programe kompjuterike që aksesonin të gjithë fondin e bibliotekës dhe mundësonin shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Referuar GVB dhe takimeve ne UMT, GVJ konstaton që UMT planifikon shtimin e zërave të literaturës në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit, duke bashkëpunuar ngushtësisht me personelin akademik në plotësim të nevojave te tij. Megjithatë në DVJ nuk ka një plan për shtimin e fondit të bibliotekës për periudhën në vijim.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Në RVB si dhe gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstaton që biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në orët 08.30 deri në 20.30 (nga e hëna deri të premtën) dhe nga ora 09.00 deri në orën 13.00.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi, ndoshta edhe prej kushteve të zhvillimit të aktiviteteve didaktike online të kushtëzuar prej pandemisë Covid-19, nuk kanë përdorur shërbimet e bibliotekës.</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>			
<p>Shkalla e përnabushjes së standardit</p>	<p>Nuk përnabushet</p>	<p>Përnabushet pjesërisht</p>	<p>Përnabushet kryesisht</p>	<p>Përnabushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i DVV, takimet me stafin akademik, studentët, stafin administrativ, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan Tirana, përdor dhe zhvillon vazhdimisht sistemet e informimit. UMT disponon sistemin e tij funksional <i>edu4schools</i>, të përshtatur me të gjitha elementet e specifikat që ka UMT dhe programet që ofron.</p> <p>UMT është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) dhe QSHA. Nëpërmjet platformave që ofrojnë këto struktura realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UMT-së, si dhe matrikullimi i studentëve bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UMT-ja.</p> <p>Gjithashtu, UMT përdor shërbimet e “ASCAL Management System” (AMS) nëpërmjet të cilit administrohen dhe menaxhohen të gjitha informacionet elektronike që lidhet me të dhënat e</p>

	<p>institucionit, strukturën akademike, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale.</p> <p>Institucioni, menaxhon një cikël të plotë të një studenti: regjistrimin, vlerësimet e studentit deri në diplomim, transferimin e studimeve të studentit, pagesat etj, në format hard copy dhe elektronik (nëpërmjet sistemit edu4schools etj).</p> <p>Aneksi 73. Metoda inovative të mesimdhënieve që përmirësojnë angazhimin e studenteve</p> <p>Aneksi Nr. 20 –Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit</p> <p>37. Nderfaqe classroom e një pedagogu;</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT;</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>UMT përdor platformën edu4school e cila është një sistem i integruar për menaxhimin e mesimdhënieve dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi, jeta universitare, e deri në mbrojtjen e diplomës. Në të janë të përfshira module që mundësojnë menaxhimin e procesit mësimor, zhvillimin, planifikimin dhe menaxhimin e llojeve të aktiviteteve të ndryshme, etj.</p> <p>Gjithashtu, komunikimi si brenda institucionit ashtu edhe jashtë tij realizohet me antë të postës elektronike në domain @umt.edu.al me të cilin është pajisur i gjithë personeli akademik, ndihmës akademik, personelit administrativ, si dhe studentët.</p> <p>Aneksi 73. Metoda inovative të mesimdhënieve që përmirësojnë angazhimin e studenteve</p> <p>Aneksi Nr. 20 –Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit</p> <p>37. Nderfaqe classroom e një pedagogu,</p> <p>Faqja zyrtare e UMT https://umt.edu.al/;</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT;</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha metodat e përdorura të ruajtjes dhe shkëmbimit të informacionit administrohen nga personi përgjegjës i sektorit të teknologjisë dhe informacionit në nivel rektorati si dhe nga drejtoria e komunikimit, të cilët janë njëkohësisht përgjegjës për sigurinë e informacionit dhe ruajtjen e tij.</p> <p>Në UMT ka rrjet të brendshëm të lidhur me internet për stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët.</p> <p>Institucioni ka siguruar për punonjësit akademikë dhe jo akademikë infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, si pajisje kompjuterike dhe shërbime interneti, pajisje të tjera të rëndësishme si printer, fotokopje, skaner, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe</p>	<p>GVJ konstaton që sistemi edu4schools përmbush kërkesat për komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Po ashtu rrjeti i brendshëm (Intranet) që</p>

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	lidh me internet stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët është një rrjet shumë i dobishëm për shkëmbime edhe konfidenciale, të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe administrativ.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Aneksi 73. Metoda inovative të mesimdhënieve që përmiresojnë angazhimin e studentëve Aneksi Nr. 20 –Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit 37. Nderfaqe classroom e një pedagogu, Faqja zyrtare e UMT https://umt.edu.al/ ; RVB; Shënime të vizitave në UMT;			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	GVJ konsultoi faqen zyrtare të UMT, ku afishohen të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme dhe konstatoi që ato publikohen në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Faqja Zyrtare (https://umt.edu.al/)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në Institucion, UMT bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik (janar-dhjetor).</p> <p>Raporti i auditit, i depozituar në QKB, përmban të gjitha detyrimet dhe të ardhurat sipas bilancit të institucionit.</p> <p>Gjithashtu institucioni harton një raport të përgjithshëm dhe jo vetëm financiar i cili depozitohet në institucionet përkatëse (ministria përgjegjëse për arsimin) sipas akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Administratori i UMT përgjigjet për realizimin e planit financiar dhe raporton në Bordin e Lartë Drejtues për veprimtarinë ekonomike-financiare.</p> <p>GVJ nuk ka në dispozicion një raport të detajuar ekonomik/financiar për këtë program studimi. Megjithatë, mendojmë se bazuar në</p>

	<p>strategjinë e zhvillimit të institucionit, UMT garanton nevojat financiare për mbulimin e këtij programi studimi.</p> <p>Aneksi 55 – Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar; Aneksi Nr.40, Shpenzime dhe te ardhura në 3 vitet e fundit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në dispozicion të GVJ nuk është vendosur një raport financiar i detajuar për program studimi apo një plan financimi të tij. Ajo që disponohet është në nivel institucioni ku detajohen shpenzimet të ndara në zërat kryesor.</p> <p>Gjithashtu, për pjesën e të ardhurave, ato paraqiten në nivel institucioni si në tabelën 18 në RVB.</p> <p>Në dokumentet mbështetëse për planin e financimit të institucionit paraqiten edhe tarifat për shkollimin pranë njësive kryesore apo të programeve të studimit në nivel master.</p> <p>Nuk paraqiten të dhëna të përpunuara për vlerësimin e mbështetjes financiare për këtë program studimi, përfshirë këtu burimet njerëzore të përfshira, shpenzimet operative, pasurimin e bibliotekës etj.</p> <p>Gjithashtu, auditimi financiar përfshin vit kalendarik, ndërsa cikli i studimeve është me vit akademik.</p> <p>Megjithatë, duke parë në tërësi, bilancin pozitiv të institucionit, gjykojmë se garanton financimin e një cikli të plotë të studimeve.</p> <p>Sugjerojmë institucionin që të hartojë raport të detajuar si dhe një plan të zhvillimit të mëtejshëm të programit të studimit dhe mbështetjen e tij. Plani duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e vullshëm të fushës së studimit në inxhinierinë e informatike. Për këtë të hartojë plan të qartë për financimin e burimeve njerëzore, bazës laboratorike (softuer dhe harduer)</p> <p>Aneksi 41. Buxheti UMT Procedura e miratimit dhe hartimit per 2019; Aneksi 55 – Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar; Aneksi Nr.40, Shpenzime dhe te ardhura në 3 vitet e fundit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në DVV, UMT kryen auditim të përvitshëm të pasqyrave financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p>Vështirësi haset në raportimin e të dhënave financiare të cilat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi janë në sipas vitit fiskal (janar-dhjetor) dhe të audituara nga ekspertët përkatës dhe të depozituara në QKB, dhe të dhënave të kërkuar për menaxhimin e brendshëm të programeve të studimit të cilat janë në bazë viti akademik (afërsisht tetor-shtator të vitit pasardhës).</p>

financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Bazuar në raportet e kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe në veçanti formati i tabelës 18 në RVB institucioni paraqet një pamje të të ardhurave nga tarifat për dhe gjatë shkollimit Aneksi 42. Evidence auditimi financiar; RVB, Tab. 18			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Institucioni harton raport të përvitshme financiare konform dispozitave ligjore në fuqi. UMT bën një analizë të përgjithshme të kostove ku përfshihen shpenzimet për mësimdhënie, pagat e stafit mbështetës administrativ, pagesat për qeranë, energjinë elektrike, telefonat, internetin, për paisjet si kompjutera, IT, paisje laboratike, blerja e licencave për programet kompjuterike, tarifat e akreditimit, bibliotekën elektronike etj dhe, mbi këtë bazë, planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Aneksi 41. Buxheti UMT Procedura e miratimit dhe hartimit per 2019; Aneksi 55 – Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar; Aneksi Nr.40, Shpenzime dhe te ardhura në 3 vitet e fundit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Bazuar në auditimin e financave të institucionit (në nivel universiteti), rezulton se UMT ka një bilanc pozitiv çka garanton qëndrueshmëri financiare dhe vijueshmëri të aktivitetit të saj. Aneksi 41. Buxheti UMT Procedura e miratimit dhe hartimit per 2019; Aneksi 30 Asetet Infrastrukturore akademike; RVB; Aneksi 42. Evidence auditimi financiar			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


74

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UMT është përgjegjëse për përcaktimin e kuotave dhe kriterëve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe, për këtë qëllim, ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatore. Në këtë kuadër, pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit https://umt.edu.al/.</p> <p>Për këtë program studimi, institucioni nuk ka hartuar kriterë specifike në pranimin e studentëve. Kriteri i vetëm, është ai i mbarimit të një cikli studimesh Bachelor në Inxhinieri (Neni 23, Politika e Pranimit e rregullores së programit të studimit), por pa specifikuar formimin e tyre në kuadër të këtij programi studimi. Patja e një kriteri kaq të gjerë, potencialisht mund të jetë një dobësi e cilësisë së pranimit të studentëve të cilët mund të vijnë nga formime inxhinierike jo të ngjashme dhe të hasin vështirësi në ndjekjen e aktiviteteve didaktike të këtij programi.</p> <p>Institucioni kujdeset që nga regjistrimi i studentëve dhe pajisja e tyre me numër matrikullimi, krijimi i dosjes së plotë të studentit dhe deri në dalje duke u kujdesur për diplomimin dhe suplementin e diplomës.</p> <p>GVJ kërkoi disa dosje studentësh (random) dhe konstatoi se ishin në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 3 Plani strategjik i zhvillimit të UMT; Aneksi 4. Rregullore e programit të studimit Aneksi 44 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit; Aneksi 50 Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT; Aneksi 47. Publikimet në ueb të njoftimeve për pranimet; https://umt.edu.al/; RVB; Shënime të vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ gjykon se institucioni garanton barazinë dhe të drejtat e studentëve në formimin e tyre akademik dhe shoqëror brenda institucionit.</p> <p>Rregulloret dhe kriteret si ato në hyrje si ato për avancimin akademik nuk paraqesin kushte apo paragraf diskriminues. Janë</p>

	<p>gjithëpërfshirëse dhe garantojnë barazinë e studentëve në qasjen me institucionin.</p> <p>Aneksi 29 Guida e studentit; Aneksi 52 Aktivitetet e Zyrë së Karrierës; Aneksi 32: Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT; Aneksi 45 _Aktivitete të kryera nga studentët_keshilli studentor; Aneksi 33 Rregullore e Këshillit Studentor UMT; RVB; Shënimet e vizitave në UMT;</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në veçanti në rregulloren e programit të studimit, vihet re një formulim i përgjithshëm, me të dhëna jo të nevojshme dhe që nuk janë kompetencë e programit të studimit, por e organeve kolegjiale apo të njësive eprore.</p> <p>Gjithashtu edhe neni 26 për “Statusin e studentit” bie ndesh me nenin 23. Këtu afirmohet që kandidati për student fiton statusin e studentit kur “ka fituar konkursin e pranimit”, por në asnjë nen të kësaj rregullore nuk flitet për konkurs pranimi. Madje, në faqen web të institucionit informacioni i pranimit është vetëm ai i mbylljes me sukses të një cikli studimesh inxhinierike bachelor.</p> <p>Gjithashtu, në rregullore nuk paraqiten kriteret, kushtet dhe procedurat për pranimin, transferimin, ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Ju kërkua, nëse ka një të tillë, të paraqiteshin kriteret për transferimin e studimeve nga një institucion tjetër në UMT. Institucioni ka venë në dispozicion “Shtojca 3 - Udhezues mbi vlerësimin dhe transferimin e studimeve pranë UMT” e cila është miratur në nëntor të vitit 2020 dhe parashikon kriteret sasiore të njohjes dhe transferimit të krediteve duke plotësuar boshllëqet e paratirura në “Procedurën e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit” (Aneksi 44).</p> <p>Megjithatë plotësimin e paraqitur në shtojcën 3, në rregulloret institucionale nuk janë të qarta kriteret dhe procedurat për pranimin e studentëve dhe ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve.</p> <p>I sugjerojmë institucionit që hartimi i këtyre kriterëve të formalizohen në rregulloren e programit të studimit nëse ka kriterë specifiqe të tij, ose në rregulloren e njësisë kryesore nëse janë të përgjithëshme. Nëse këto kriterë janë dinamike, të paraqiten në rregullore kriteret dhe kushtet e modifikimit të tyre, dhe ku studentët ose kandidatët për student të gjejnë informacionin e azhornuar.</p> <p>Edhe pse institucioni ka të publikuar në faqen web zyrtare të dhëna dhe kriterë të pranimit, transferimit të studimeve, mendojmë se ato</p>




	<p>duhet të reflektohen edhe në dokumentat zyrtare të institucionit dhe të ruhen dhe arkivohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p>Të dhënat në faqen web, nuk përbëjnë dokument zyrtar ligjor, ato janë objekt i ndryshimeve të vazhdueshme nga institucioni dhe nuk ka procedura ligjore për ruajtje dhe arkivimin e tyre.</p> <p>Aneksi 02. Rregullore e Brendshme UMT; Aneksi 04. Rregullore e programit të studimit; Aneksi 15. Rregullore e sekretarise mesimore; Shtojca 3 - Udhezues mbi vleresimin dhe transferimin e studimeve prane UMT Aneksi 48. Shembull dosje studenti te regjistruar Aneksi 44 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit; Aneksi 47. Publikimet ne ueb te njoftimeve per pranimet; https://umt.edu.al/ RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ konsultoi dokumentacionin lidhur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve dhe konstatoi që kriteri bazë është ai i përfundimit të një cikli studimesh inxhinierike të nivelit paraardhës.</p> <p>Megjithatë, duke parë edhe thelbin e këtij programi studimi, sugjerojmë që institucioni të hartojë kritere shtesë për pranimin e studentëve në këtë program studimi. Kritere cilësore që lidhen me njohuritë paraprake të aplikantëve në fushën e inxhinierisë informatike do të ishin të rekomanduara si kritere shtesë për përzgjedhjen e kandidatëve. Rritja e njohurive paraprake në hyrje do të rriste edhe zhvillimin e mëtejshëm jo vetëm të vet studentëve por edhe të institucionit dhe anës së tij kërkimore-shkencore.</p> <p>Student që kanë formim inxhinierik në programe Bachelor jo të drejtimeve të lidhura me ato të Inxhinierisë Informatike, pranojnë në këtë program studimi sipas rregullores në fuqi, por kjo përbën një bazë studentësh me njohuri paraprake jo të përshtatshme dhe të mjaftueshme për ndjekjen e këtij programi studimi.</p> <p>Tabela 21 në RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Në faqen zyrtare të institucionit https://umt.edu.al/, përpara fillimit të çdo viti akademik, UMT udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit në vlerësim. Po kështu këtij qëllimi i shërbejnë edhe aktivitetet e posaçme të cituara më lart si dhe informacionet e posaçme që japin Zyra e Këshillimit të Karrierës, ajo e Shërbimit ndaj Studentit etj.</p> <p>Aneksi 44 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit; Aneksi 48 Shembull dosje studenti te regjistruar; Aneksi 47. Publikimet ne ueb te njoftimeve per pranimet; https://umt.edu.al/</p>

	RVB; Shënimet e vizitave në UMT			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Sa i përket informacionit që vë në dispozicion UMT për kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, GVJ konstatoi që këto informacione i vihen në dispozicion studentit nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në faqen zyrtare të institucionit dhe nëpërmejt akteve rregullative të institucionit. Rol të rëndësishëm luajnë edhe këshillat studentorë, shënimet që mbahen nga stafi akademik, stafi ndihmës akademik, sekretaria mësimore si dhe sistemi edu4schools. Përdorimi i të gjitha këtyre burimeve dhe shfrytëzimi i të gjitha këtyre mundësive bën që informacioni mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve të jetë i plotë dhe i hollësishëm.</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 17 Rregullore e FSHKIT, Aneksi 29 Guida e studentit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Dosjet personale të studentit ruhen e menaxhohen nga sekretaria mësimore. Në këto dosje gjenden informacione mbi adresat, e-mailat dhe numrat e telefonit të studentëve të UMT-së, që janë të përfshirë në formë elektronike në databazat e secilit Fakultet. Pjesë e sistemit të informimit janë edhe kriteret dhe procedura e transferimeve drejt programeve të studimit që ofron FSHKIT.</p> <p>Në rregulloren e përgjithshme të institucionit, atë të sekretarisë mësimore por edhe atë të programit të studimit, paraqiten të drejtat e studentit për të kërkuar njohjen e kualifikimeve të mëparshme, por nuk janë të qarta rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur. Gjatë vizitës në institucion, u qartësua se përgjegjës për anën procedurale është sekretaria mësimore, ndërsa për vlerësimin e kualifikimeve të mëparshme është departamenti përgjegjës për programin e studimit.</p>

	<p>Të dhënat e ofruara gjatë vizitës në institucion janë koherente me rrjedhën logjike të vlerësimit të kualifikimeve, por nuk janë të saktësuara qartë në rregulloret përkatëse.</p> <p>Sugjerojmë institucionit në hartimin e rregulloreve të brendëshme në mënyrë më të qartë edhe për studentët. Në këtë mënyrë mund të zvogëlohet edhe nevoja për sqarime e studentëve pranë organeve drejtuese të institucionit.</p> <p>Ne dosjet e studenteve ruhen kualifikimet e mehershme apo studimet e pjesshme.</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 17 Rregullore e FSHKIT; Aneksi 44 Procedurat e aplikimit, rregjistrimit dhe transferimit; Aneksi 29 Guida e studentit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që sistemi i menaxhimit edu4schools funksionon për t'u dhënë studentëve saktë dhe në kohë të gjitha informacionet lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu në syllabuset e lëndëve paraqiten edhe kriteret dhe procedurat për vlerësimin e dijeve të secilës lëndë.</p> <p>Mundësi të tjera jepen nga përdorimi i faqes zyrtare të UMT, të drejtë përdrejtë të studentëve në Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe asaj të Mbështetjes së Studentëve etj.</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 29 Guida e studentit; Aneksi 37. Nderfaqe classroom; RVB; Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, në takimet me studentët dhe personelin akademik GVJ mësoi se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike jep informacione lidhur me mënyrën e punimit të tezës së diplomës si për formatin e shkrimit ashtu edhe për organizimin e përgjithshëm të saj. Në mbështetje të këtij procesi japin informacione edhe dekanati i Fakultetit, po ashtu edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës.</p> <p>RVB; Shënimet e vizitave në UMT; Aneksi 58. VSA mbi udhëheqjen e diplomave; Aneksi 59. Rregullore e temes së diplomes</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri UMT organizon aktivitete të tilla si "Dita e Informimit", "Për një ditë student në UMT", "Panairi i punës", boton dhe shpërndan "Guidën e studentit" si dhe informon nëpërmjet faqes zyrtare të UMT-së https://umt.edu.al/ .</p> <p>Aneksi 47. Publikimet ne ueb te njoftimeve</p>

studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Aneksi 29 Guida e studentit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike, studenti informohet nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare https://umt.edu.al/ , komunikimi në domain-in @umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta me “Sekretarine Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, koordinatori i departamentit etj. Aneksi 47. Publikimet ne web te njoftimeve, Aneksi 23 Plani mësimor; Aneksi 24 Plan programet (syllabuset) e lëndëve, Aneksi 61 Te dhena për programin RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të cdo semestri, në takimin e parë me pedagogun e lëndës, studentët informohen në lidhje me lëndën, argumentat që trajtohen, pritshmëritë e dijeve që do të marrin, literaturën përkatëse dhe format e vlerësimit të dijeve. Informacione të detajuara studentët mund të marrin edhe në platformën elektronike edu4schools, kontaktet e drejtpërdrejta me “Sekretarine Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, koordinatorin e departamentit etj. Aneksi 31 Rregullore e etikës UMT; Aneksi 23 Plani mësimor; Aneksi 24 Plan programet (syllabuset) e lëndëve, Aneksi 61 Te dhena per programin; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit,	Mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështetjen që jep institucioni për orientimin drejt dhe në tregun e punës, studenti informohet po

<p>si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>ashtu nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare https://umt.edu.al/, komunikimi në domain-in @umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta me “Sekretarine Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, Zyrën Alumni, koordinatorin e departamentit etj. Rol të veçantë në këtë drejtim marrin Zyra e Këshillimit ta Karrierës”, Zyra e Mbështetjes së Studentëve” dhe Zyra Alumni. Në takimin me studentët GVJ mësoi se prej këtyre zyrave marrin shërbimin e duhur.</p> <p>Aneksi 20. Udhezues i teknologjise; Aneksi 52. Rrjeti alumni dhe aktivitete; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit në UMT studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjatë takimit me studentët ata pohuan disponimin e këtij informacioni dhe lehtësitë e aksesimit në të.</p> <p>Aneksi 20. Udhezues i teknologjise; Aneksi 52. Rrjeti alumni dhe aktivitete; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstatoi që në UMT sistemi i informacionit të brendshëm funksionin mirë në të gjitha format e organizimit të tij, kryesisht në platformën edu4schools, faqen zyrtare https://umt.edu.al/, komunikimin në domain-in @umt.edu.al, platformën e mësimi online GoToMeeting. Në të gjitha këto forma menaxhimi informacioni është lehtësisht i arritshëm dhe shterues.</p> <p>Aneksi 20. Udhezues i teknologjise; Aneksi 52. Rrjeti alumni dhe aktivitete; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>UMT përdor platformën edu4school e cila është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi, jeta universitare, e deri në mbrojtjen e diplomës. Në të janë të përfshira module që mundësojnë menaxhimin e procesit mësimor, zhvillimin, planifikimin dhe menaxhimin e llojeve të aktiviteteve të ndryshme, etj.</p> <p>Gjithashtu, komunikimi si brenda institucionit ashtu edhe jashtë tij realizohet me antë të postës elektronike në domain @umt.edu.al me të cilin është pajisur i gjithë personeli akademik, ndihmësakademik, personelit administrativ, si dhe studentët.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore ju vendos në dispozicion rregjistrat e studentëve të diplomuarve për Programin e Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike " në vite të ndryshme.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Për 3 vitet akademike kemi të dhëna si mëposhtë: - v.a 2018-2019 (8 studentë) - v.a 2019-2020 (17 studentë) - v.a 2020-2021 (23 studentë) Institucioni administron, ruan dhe arkivon çdo dokument dhe informacion zyrtar që lidhet me aktivitetin e tij. Në këtë kuadër, për ruajtjen e dokumentacionit në letër dhe në formë elektronike në nivel institucioni ka një Zyrë të Protokoll-Arkivës, e cila është përgjegjëse për ruajtjen dhe dokumentimin e dokumentacionit zyrtar në përputhje me Ligjin e Arkivave Nr. 9154, datë 6.11.2003 dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Arkivimi i dokumentacionit (materialet shkresore, akademike apo financiare) ruhen në dosje të veçanta të ndara në vite.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në UMT arkiva themelore përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrën e sekretarive mësimore Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin themeltar për çdo program studimi, regjistrin e diplomave të lëshuara, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, botime dhe procedura publikimi, bazë të dhënash në lidhje me aktivitetet e organizuara etj
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve

Në regjistër hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin.

FSHKIT ka arkivën e vet. Pjesë e arkivës është dokumentacioni që lidhet me rregulloret e programeve të studimit, ngarkesën mësimore të pedagogëve, marrëveshjet vjetore të stafit akademik, dokumentacion provimesh, punime diplomash të studentëve, të dhëna të aktivitetit shkencor, raporte analize dhe çdo dokumentacion që gjykohet i rëndësishëm në dokumentimin dhe sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike të njësisë. Pjesë e dokumentacionit janë po ashtu dhe dosjet e stafit akademik, kualifikimet e tyre në vite, aktiviteti shkencor si dhe vlerësimet periodike të performancës.

Në bazë të akteve normative, studentët kanë të drejtën e tërheqjes së dosjes individuale, por duke lënë në arkivë një kopje të saj, të sigluar nga personi dhe arkiva. Bazuar në LAL 80/2015, UMT ruan kopje elektronike të dokumentacionit zyrtar. Sistemi i menaxhimit edu4schools i cili është aktualisht në përdorim në UMT/FSHKIT mundëson shërbime të cilat janë në implementim e sipër.

Nëpërmjet sistemit, fakulteti disponon të dhënat e personelit akademik dhe studentëve të cilat përditësohen nga profili individual i përdoruesit. Ndërkohë, sekretaria mësimore dhe administratori i sistemit në UMT, kanë të drejtën e gjenerimit të statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, transferimet, largimet dhe të diplomuarit në çdo vit akademik. Të dhënat e gjeneruara përdoren për analiza të ndryshme të institucionit, analizën vjetore dhe publikime. (Aneksi 55, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2018-2019)

Sistemi mundëson ndjekjen e ecurisë së studentëve pasi në të regjistrohen notat e marra në të gjitha lëndët/modulet, frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të paracaktuara në çdo lëndë/modul.

Proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve realizohen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës. Informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm. Ky informacion është konfidencial dhe mund të aksesohet vetëm përmes një kërkesë me shkrim apo zotërimit të një llogarie nga student, për të dhënat e tij për sa kohë studenti është i regjistruar. Ky i fundit përmes llogarisë personale mund të shikojë vetëm ecurinë e tij në sistem dhe të marrë të dhëna për këtë. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit nga sekretaria mësimore dhe çdo veprim mbi to është lehtësisht i

	<p>verifikueshëm nga personat e autorizuar. Sistemi regjistron automatikisht çdo editim, ndërhyrje, kohën e ndryshimit dhe llogarinë nga ka ardhur ndryshimi. Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe. Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme.</p> <p>Aksesi në sistemin edu4schools të UMT është i autorizuar dhe i monitoruar. Çdo informacion në sistem konsiderohet i klasifikuar dhe çdo ndërhyrje në të për qëllime të tjera përveç atyre të përcaktuara në profilin e çdo përdoruesi, dënohen sipas përcaktimeve ligjore.</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 48 Shembull dosje studenti te regjistruar; Aneksi 15 Rregullore e Sekretarisë; Aneksi 35 Rregullore e arkivës; Aneksi 74. Shembuj nga perdorimi i Edu4school dhe gotomeeting, Aneksi 20 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve, Aneksi 55 Raporti i aktivitetit mësimor, kërkimor e financiar; Dosja e vetëvlersimit; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>			
Sbkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Përfaqësimi i studentëve në nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të UMT, është garantuar në Statut dhe aktet rregullatorë të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Dekanatin e Fakultetit, në komisionet ad-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi duke u nxitur të marrin pjesë në jetën universitare dhe duke integruar sugjerimet e tyre në veprimtarinë e përditshme të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje,</p>	

<p>këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshilli studentor i UMT (KS UMT) është organ kolegjal, përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi institucional me këto organe është një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Këshilli Studentor ka rregulloren e vet të funksionimit dhe e bazon veprimtarinë e vet në procedura të miratuara nga studentët. Aktivitetet e KS mbështeten në forma të ndryshme nga ana e institucionit.</p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Organizohen periodikisht aktivitete dhe evente të shumta me karakter akademik, social kulturor etj. Studentët e FSHKIT dhe nëpërmjet KS ose individualisht janë ftuar të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë në projekte e aktivitete shkencore e sociale, të cilat rrisin dhe përmirësojnë jetën sociale e profesionale të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>KS në bashkëpunim me Fakultetin dhe struktura të tjera të UMT, kryen një sërë aktivitete në vit, duke u nisur nga Konferencat studentore të mbështetur nga institucioni, apo në aktivitete ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive duke punuar tema shkencore dhe eksperimentale nën udhëheqjen e profesorëve, trajnime me tematika të ndryshme brenda e jashtë vendit. Nëpërmjet KS, studentët japin mendime për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, kurrikulat e programeve, praktikat, sezonet e provimeve etj. Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies në programin e studimit është i vazhdueshëm dhe bazohet në bashkëpunimin student-pedagog dhe për këtë FSHKIT/UMT motivon studentët për bashkëpunim të vazhdueshëm.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Studentëve të të gjitha programeve të studimit, u mundësohet dhënia e mendimit për metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. UMT ka të përcaktuar në rregulloren e provimeve dhe të programit të studimit modalitetet e këtij procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit.</p> <p>Aneksi.01, Statuti i UMT; Aneksi.02, Rregullore e UMT; Aneksi. 65. Anetaret e njësise se sigurimit te brendshem te cilesise; Aneksi 5 Rregullore e NjSBC; Aneksi 32: Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT-së; Aneksi 33 Rregullore e Këshillit Studentor UMT; Aneksi 17 Rregullore e programit, Aneksi 26 Rregullore e provimeve; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>			
	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
--	--	--	--	----------

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Gjatë takimit me stafin akademik u vu re se në përgjithësi stafi është i përfshirë në aktivitete kërkimore shkencore edhe për qëllime të avancimit akademik personal.
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh institucionale me universitete partnere për zhvillimin e aktiviteteve didaktike dhe kërkimore shkencore të përbashkëta. Për disa prej tyre ka edhe efektivisht shkëmbie të stafit dhe studentëve. Aneks 63. Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te studimit Aneks 57. Lista e marreveshjeve Erasmus Aneks 66. Lista e shkembimeve ne kuader te Erasmus + Aneks 43. Udhezues per plotesimin e planit te mobilitetit per stafin akademik ne kuader te ERASMUS+
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Sipas vizitës në Institucion, personeli akademik inkurajon studentët të shkruajnë dhe botojnë studime punimi shkencore. Kjo përgjithësisht është realizuar në bashkëpunim pedagog udhëheqës-student gjatë përgatitjeve të punimeve të diplomës.
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Edhe nga analiza e publikimeve të stafit akademik të departamentit të paraqitur, rezultojnë publikime të viteve të fundit. Edhe pse ky dokumentacion (Aneks 49) emërtohet si “Lista e publikimeve te stafit akademik te departamentit te inxhinierise kompjuterike”, në të janë përfshir edhe staf akademik jo pjesë e departamentit përgjegjës për programin e studimit. Aneks 49. Lista e publikimeve te stafit akademik te departamentit te inxhinierise kompjuterike
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Studentët motivohen në zhvillimin e projekteve inovative dhe pjesëmarrje në projekte të udhëhequr nga stafi akademik. Megjithatë, nuk rezultojnë botime inovative apo patenta me pjesëmarrës stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.

	Aneks 73. Metoda inovative te mesimdhenies qe permiresojne angazhimin e studenteve			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Institucioni vë në dispozicion të studentëve ambientet laboratorike për zhvillimin e pjesëve praktike/eksperimentale të punimeve të diplomave. Punimet e diplomave të studentëve ndiqen nga udhëheqësi i tyre, pedagog i departamentit i cili i udhëzon gjatë kësaj faze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	<p>Institucioni në përgjithësi është i prirur për të rritur bashkëpunimin me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe atyre industriale. Kjo vihet re edhe nga numri i lartë i marrëveshjeve të nënshkruara.</p> <p>Në kuadër të këtyre marrëveshjeve ka patur edhe shkëmbime të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Aneks 56. Lista e kompanive me te cilat institucioni ka marreveshje bashkëpunimi</p> <p>Aneks 57. Lista e marreveshjeve Erasmus</p> <p>Aneks 66. Lista e shkëmbimeve ne kuader te Erasmus +</p> <p>Aneks 43. Udhëzues per plotesimin e planit te mobilitetit per stafin akademik ne kuader te ERASMUS+</p>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	<p>Në përgjithësi, organizimi i programit të studimit në nivel Master i Shkencave, është me një profil teorik shkencor të tillë që formon studentët me njohuri të nevojshme për thellimin e tyre të më tejshme në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>Megjithatë, sikurse është përmendur në standardet e më sipërme, disa prej lëndëve paraqesin argumenta bazë dhe kanë nevojë për përmirësim.</p> <p>Aneks 24. Silabuset e Lendeve</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Institucioni ka përfshirë në projektet tek të cilat është organizator apo pjesëmarrës edhe studentët.</p> <p>Në kuadër të projekteve Erasmus+ ka patur shkëmbime të studentëve me universitetet partnere, por nuk janë përfshirë student të këtij programi studimi, pavarësisht se ky rezulton i hapur që prej vitit 2013.</p> <p>Aneks 66. Lista e shkëmbimeve ne kuader te Erasmus +</p>			
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni, edhe në kuadër të rekrutimit të stafit të ri për plotësimin e nevojave akademike por edhe në promovimin e stafit ekzistues motivon për zhvillimin e aktiviteteve kërkimore dhe projekteve. Aktivitete që përfshijnë edhe studentët kryesisht të nivelit master i shkencave.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi jo vetëm me institucione akademike partnere por edhe me kompani dhe aktor të biznesit.</p> <p>Në kuadër të marrëveshjeve institucionale dhe projekteve Erasmus+, institucioni ka realizuar shkëmbim të stafit akademik dhe të studentëve</p> <p>Aneks 66. Lista e shkëmbimeve ne kuader te Erasmus +</p> <p>Aneks 43. Udhezues per plotesimin e planit te mobilitetit per stafin akademik ne kuader te ERASMUS+</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Megjithëse institucioni ka të nënshkruara një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare dhe në kuadër të projekteve Erasmus+, nuk ka një evidencë të përfshirjes së personelit akademik të huaj dhe student të huaj në këtë program studimi.</p> <p>Për të rritur cilësinë në tërësi të institucionit, GVJ sugjeron që të ftohen personel akademik i huaj për të realizuar aktivitete akademike në kuadër të këtij programi studimi në veçanti dhe për programet e studimit të ofruara nga institucioni në tërësi.</p> <p>Aneks 66. Lista e shkëmbimeve ne kuader te Erasmus +</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>GVJ, referuar RVB, mëson që UMT ka të ngritur një sistem funksional informacioni për të përçuar tek studentët gjithë çfarë atyre u nevojitet në lidhje me programin: procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, rregulloren e provimeve, procedurat që lidhen me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor etj. Në rang institucioni funksionon dhe një zyrë e posaçme e informimit të studentëve dhe e publikut që në organogramë quhet Drejtoria e Komunikimit. Informacionet shpërndahen si në hard copy ashtu edhe në format elektronik. Informacionet merren edhe nga faqja zyrtare e institucionit si dhe koordinatorët e programit. Po ashtu studenti informohet në kuadër të departamentit për organizimin e mësimit, aktivitetet e ndryshme, diplomimin, ecurinë e procesit mësimor etj. Në strukturën organike të njësisë kryesore, informacione për studentët japin edhe Sekretaria Mësimore, Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Mbështetjes së Studentëve etj. Aktiviteti informues i këtyre shërbesave rregullohet sipas parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore të UMT. Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaktoi përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, NjSBC, Zyrës së Kurrikulës e Cilësisë, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrës së Shërbimit të Studentëve, Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë, Zyrës së Hartimit e Menaxhimit të Projekteve. Në të gjitha këto takime GVJ u informua për aktivitetin e tyre në shërbim të studentëve.</p> <p>Aneksi 39 Organigrama, struktura e UMT; Aneksi 17 Rregullore e FSHKIT; Aneksi 15 Rregullore e Sekretarisë; Aneksi 46. Rregullore mbi funksionimin e zyrës së karrierës UMT; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Siç u trajtua më sipër institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Aneksi 17 Rregullore e FSHKIT RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin</p>	<p>UMT ofron shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Nga kjo zyrë merren informacione në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për</p>

e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Aneksi 17 Rregullore e FSHKIT; Aneksi 46. Rregullore mbi funksionimin e zyrës së karrierës UMT; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/			
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Gjatë vizitës në UMT në takimin me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, GVJ konstatoi që kjo zyrë ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Aneksi 46. Rregullore mbi funksionimin e zyrës së karrierës UMT; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore	Institucioni ka të sanksionuar në Statut përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies.

<p>në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>NJSBC është ngritur me Vendim të Senatit Akademik, dhe ka në përbërjen e saj 5 anëtarë të përhershëm dhe 1 ekspert të jashtëm.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NJSBC ka hartuar politikat e Cilësisë në institucion, funksionon mbi bazën e rregullores së NJSBC, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe (një) ekspert i jashtëm dhe (një) përfaqësues i administratës. Anëtarët e Njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Angazhimin institucional për krijimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, UMT e ka parashikuar në planin e zhvillimit strategjik të institucionit, në të cilin parashikohet përgjegjësia institucionale për konsolidimin e cilësisë dhe mekanizmat me të cilat kjo do të arrihet. Gjithashtu, institucioni në plotësim të objektivave strategjike të tij lidhur me sigurimin e cilësisë, ka në nivel drejtuesi zv/rektorin për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Megjithatë, rregullorja është shumë e përgjithëshme dhe nuk qartëson funksionimin e kësaj njësie.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Gjithashtu, edhe nga përmbajtja e dosjes së vetë vlerësimit të këtij programi studimi janë vërejtur nga GVJ pasaktësi dhe mospërputhje në dokumentacion. Problematika që duhet të adresohen nga NJSBC-ja me akte proceduriale të tilla që hartimi i dokumentacionit të institucionit të jetë i qartë, i saktë dhe konform të gjitha akteve rregullatore në fuqi dhe në shërbim të rritjes së cilësisë së institucionit.</p> <p>NJSBC harton në mënyrë periodike anketime të procesit mësimor dhe atij shkencor si për studentët ashtu edhe për stafin akademik. Të dhëna që paraqiten në formë raporti për organet eprore.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pyeti në lidhje me interpretimin e rezultateve dhe mekanizmave formal, sasior në interpretimin e tyre për të nxjerrë të dhëna të dobishme në rritje të cilësisë së institucionit. Gjatë këtij takimi edhe me stafin akademik edhe me anëtarët e NJSBC u vu re se pyetësorët e hartuar për studentët në interpretimin e të dhënave nuk korrelohen për të nxjerrë efektivisht burimin e problematikave (në rast se ka), por bëhet vetëm një analizë e pyetjeve thuajse të pavarura nga njëra-tjetra.</p> <p>Megjithatë vlerësojmë pozitive hartimin e raporteve nga NJSBC dhe mënyrën e interpretimit të të dhënave në nivel institucioni dhe jo vetëm program studimi, sikurse paraqitet edhe në aneksin 53. NJSBC bën një interpretim të pyetjeve për ti ndërthurur me njëra-tjetrën për të nxjerrë informacione në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p>

	<p>Sugjerojmë që institucioni të hartojë procedura për interpretimin e pyetësorëve/anketimeve të tillë që përgjigjet në pyetje të ndryshme të mund të korrelohen mes tyre për të zhveshur përgjigjet nga subjektivizmi i studentit dhe identifikuar më mirë pikat e dobëta që mund të kenë nevojë për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>Sugjerojmë institucionin të hartojë politika më të qarta të vlerësimit të cilësisë, rolin e NJSBC-së dhe funksionimin e saj në institucion. Stafit akademik të njihet me rregulloren, kriteret dhe procedurat e NJSBC-së dhe se si ato mund të preken prej tyre apo të ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në institucion.</p> <p>Aneksi 5 Rregullore e NJSBC;</p> <p>Aneksi 53. Analiza e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik;</p> <p>Aneksi. 78. Anetaret e njesise se sigurimit te brendshem te cilësisë;</p> <p>Aneksi 51.Politika e cilesise te Universitetit Metropolitan Tirana;</p> <p>Aneks 12. Pyetesori i studenteve per mesimdhënie online;</p> <p>Aneks 34. Modeli i pyetesorit per studentet</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>UMT si IAL ka ngritur njësitë e tij për sigurimin dhe realizimin e cilësisë. Njësia përgjegjëse për programin në vlerësim është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Kjo njësi koordinon të gjithë aktivitetet didaktike të programit, si dhe koordinon punën për realizimin sa më cilësor të tij.</p> <p>Në UMT përgjegjësia administrative për sigurimin e cilësisë bie mbi drejtuesin e departamentit dhe koordinatorin e programit të studimit edhe pse detyrat e këtij të fundit janë në formë koordinimi, por pa specifikuar rregulloret e arritjes së tyre.</p> <p>Edhe në rregulloren e programit të studimit, në atë të koordinatorit të programit apo edhe të fakultetit nuk janë të qarta dhe të pasqyruara të</p>

	<p>dhëna rreth njësave përgjegjëse për rishikimin e programeve të studimit apo koordinimin me njësitë e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Edhe pse institucioni, në organizimin e brendshëm ndjek disa procedura për rishikimin e programeve të studimit, ato nuk janë të formalizuara në rregullore dhe veprohet në bazë të përvojës së vet stafit akademik dhe të komunikimit të tyre të brendshëm. Procedura që kanë rezultuar efektive në mirëfunksionimin e institucionit.</p> <p>Sugjerojmë institucionin të formalizojë procedurat që efektivisht ndjek në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë.</p> <p>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 4 Rregullore e programit të studimit; Aneksi 5 Rregullore e NJSBC; Aneksi 79. Manuali i sigurimit të cilësisë të Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 51. Politika e cilësisë të Universitetit Metropolitan Tirana RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me njësinë e sigurimit të cilësisë, u vu re se kjo zyrë harton raporte bazuar kryesisht mbi anketimet e studentëve. Ekzistojnë edhe procedura për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime të tyre.</p> <p>UMT ka mekanizma të tillë si analiza vjetore në rang fakultetesh, ku evidentohet cilësia e personelit akademik, cilësia e syllabuseve, cilësia e literaturës së përdorur, rezultatet e studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit etj, duke hartuar një plan masash për përmirësim e programit të studimit.</p> <p>Por mund të themi se këto procedura nuk janë efikase, të paktën për këtë program studimi, pasi vërejmë se në kuadër të cilësisë këto procedura nuk kanë dhënë rezultatin e duhur. Sikurse është përmendur edhe në standardet më sipër, institucioni ka paraqitur në dosje dokumentacione kontradiktore mes tyre, por edhe dokumentacion jo konform akteve rregullatore të cilësisë në IAL. Mjafton të përmendim mospërputhjen në tabelat sasiore të dosjes së vlerësimit të jashtëm, syllabuse të lëndëve jo konform programit të studimit, literaturë e vjetëruar etj.</p> <p>Sugjerojmë institucionit të formalizojë më mirë procedurat e vlerësimit të cilësisë si dhe të trajtojë më mirë stafin administrativ në hartimin e dokumentacionit konform akteve rregullatore në fuqi.</p> <p>53. Analiza e NJSBC për pyetesoret e stafit akademik; Shënimet e vizitave në UMT;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe</p>	<p>Si metodologji vlerësimi, në UMT përdoren “Pyetesoret për vlerësimin e pedagogëve” që plotësohen në fund të çdo semestri nga studentët.</p>

<p>vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Përdoret si metodologji edhe vlersimi i performances akademike në mësimdhënie, kërkim shkencor e projekte për stafin akademik.</p> <p>Aneksi 4. Rregullore e Programit; Aneksi 5. Rregullore e NjsBC; Aneksi 79. Manuali i sigurimit te cilesise te Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 51. Politika e cilesise te Universitetit Metropolitan Tirana; Aneks 12. Pyetesori i studenteve per mesimdhениen online; Aneks 34. Modeli i pyetesorit per studentet; Aneksi 36 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës; Tabela 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për Program Studimi;</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha gjetjet në procedurat dhe metodologjitë për sigurimin e cilësisë u përcillen autoriteteve vendimmarrëse për programin e studimit (përgjegjës departamenti/dekan) si dhe organeve kolegjiale (dekanati/senati akademik) të cilët, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore marrin masat përkatëse.</p> <p>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 4 Rregullore e Programit; Aneksi 5 Rregullore e NjsBC; Aneksi 79. Manuali i sigurimit te cilesise te Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 51 Politika e cilesise te Universitetit Metropolitan Tirana; Aneksi 36 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës; RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë analizën e anketimeve dhe vënien në dukje të gjetjeve të tyre. Por nuk ka të dhëna mbi vlerësimet, vendimet, planet e masave dhe objektivat e vendosura nga institucioni për të adresuar gjetjet e raporteve të hartuara nga NJSBC apo organet e tjera në kuadër të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>Gjykojmë se institucioni vepron në përmirësimin e cilësisë me procedura të padokumentuara qartësisht, të cilat kanë sjellë rritje të cilësisë së institucionit sikurse mund të kuptohet edhe nga historia e akreditimeve të programve të studimit dhe atij institucional. Megjithatë GVJ mendon se institucioni ka vend për përmirësime të mëtejshme në procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe trajnimin e stafit që angazhohet në këto detyra.</p> <p>Aneksi 36 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës; Aneksi 17 Rregullore e FSHKIT; Aneksi 55 Raport vjetor i aktivitetit mësimor kërkimor e financiar; Aneksi 14. Raportet vjetore te publikuara per monitorimin dhe sigurimin e cilesise. Aneksi 28 Vendimi i Senatit për vlerësimin e vazhduar RVB; Shënimet e vizitave në UMT; https://umt.edu.al/</p>			
	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
--	--	--	----------	--

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe në veçanti me takimin me GVB, vihet re se ky grup ka bashkëpunuar me të gjitha hallkat e institucionit për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat e nevojshme për vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p>UMT për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metodat e mëposhtme të vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimin nga NjsBC në nivel institucional; • Monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit; • Vlersime nga komisione ad-hoc të ngritura nga dekani në bashkëpunim me NjsBC.; • Sondazhe, anketime dhe mbledhje informacioni nga studentët • Monitorime nga drejtuesit e departamentit
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që në UMT në kuadër të vlerësimit, realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ.</p> <p>Megjithatë nuk ka të dhëna mbi objektivat e vendosura dhe hapat për t'i arritur ato, bazuar në gjetjet e vlerësimeve të sipër përmendura.</p> <p>Aneksi 62. VBA për akreditimin institucional të UMT;</p> <p>Aneksi 51. Politika e cilësisë UMT;</p> <p>Aneksi 17. Rregullore e FSHKIT;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Aneksi 14. Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë;</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit,</p>	

<p>mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>Aneksi 21. Raporti mbi rezultatet e pyetsorit;</p> <p>Aneksi 55. Raporti vjetor i aktivitetit mesimor kerkimor dhe financiar;</p> <p>Shënimet e vizitave në UMT</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentet rregullatore të këtij institucioni thuhet se “<i>të gjitha strukturat përbërëse të UMT janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që ai ofron bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore.</i> Synimi kryesor i përcaktuar në këto akte është gjithëpërfshirja e kontribuesve në procesin e mësimdhënjes dhe aktiviteteve të tjera akademike. Në këtë kuadër, përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit në vlerësim është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Pikërisht kjo njësi përgjegjëse ka ngritur, propozuar, aktivizuar e monitoruar gjithë aktivitetin për SC. Po ashtu fakulteti ka koordinuar këtë aktivitet, realizimi i të cilit pastaj kërkon gjithëpërfshirje të strukturave të institucionit. RVJ konstaton që SC për programin në vlerësim është realizuar me përfshirjen e gjithë aktorëve, të brendshëm e të jashtëm, të interesuar dhe të ngarkuar për këtë process.</p> <p>Aneksi 2 Rregullore e UMT; Aneksi 62 Vendimi për akreditimin institucional të UMT nga BA dhe certifikata e cilësisë;</p>

	<p>Aplikimi në ASCAL për akreditimin e PS mbi fillimin e procesit të vlerësimit;</p> <p>Aneksi 51 Politika e cilësisë UMT;</p> <p>Aneksi 17 Rregullore e FSHKIT;</p> <p>RVB Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UMT, mbështetur në aktet ligjore (Ligji 80/2015) dhe ato rregullatore ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe kërkon e garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kryesore në këtë proces është NjsBC, në përbërje të së cilës ka aktorë të brendshëm, studentë dhe aktorë të jashtëm. Të dhënat e kërkuara dhe të siguruar nga kjo zyrë i vihen në dispozicion GVB i cili harton RVB. GVJ i ka konsultuar të gjitha materialet e DVV, ka hartuar protokollin e takimeve në institucion dhe konstaton që aktorët e ngarkuar për SC i kanë ushtruar me përgjegjësi detyrat e tyre.</p> <p>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</p> <p>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirane;</p> <p>Aneksi 3 Plani strategjik i zhvillimit të UMT;</p> <p>Aneksi 5 Rregullore e NjsBC;</p> <p>Aneksi 79. Manuali i sigurimit të cilësisë të Universitetit Metropolitan Tirana;</p> <p>Aneksi 51. Politika e cilësisë të Universitetit Metropolitan Tirana;</p> <p>Shënime të vizitave në UMT</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtimin e gjithë materialeve të DVV si dhe në takimet gjatë vizitës në UMT, GVJ vlerëson se njësi bazë dhe ajo kryesore janë përfshirë në sigurimin e dokumentacionit të kërkuar për hartimin e DVV.</p> <p>Shënime në vizitë</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në vizitën në institucion, dhe në veçanti takimi me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, vlerësohet respektimi i fushave të ekspertizës për secilin prej anëtarëve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion.</p> <p>Shënime në vizitë</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin</p>	<p>NjsBC por edhe grupi i vlerësimit të brendshëm përbëhet nga anëtarë të brendshëm të institucionit.</p> <p>Gjatë takimit në institucion, në veçanti takimi me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar</p>

e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të silabuseve të lëndëve. Ka edhe tentativa bashkëpunimi me universitete jashtë Shqipërisë për diploma të dyfishta apo njohje reciproke të programeve të studimit. Shënime në vizitë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit në transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen zyrtare në web publikohen raporte të përmbledhura për programet e studimit të cilat evidentojnë kryesisht pikat e forta të institucionit [https://umt.edu.al/njofitime-dhe-publikime]. Të dhëna më të detajuara u ofrohen studentëve gjatë nënshkrimit të kontratës kur regjistrohen si studentë në një program studimi. Në këtë fazë studenti njihet me dokumentin e performancës së institucionit dhe në veçanti për programin e studimit të përzgjedhur.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të pyetësorëve të organizuar jepen në formë të përmbledhur. Të dhënat jepen në formë anonime dhe statistikore në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10 Mars 2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Të përmbledhur jepen edhe të dhëna tërësore si për programe studimi ashtu edhe për institucionin të publikuara në faqen ueb zyrtare Të dhënat e aksesueshme nga stafi në kuadër të raporteve apo anketimeve në lidhje me cilësinë e brendshme apo raporte specifike mbi vlerësimin e stafit janë konfidenciale në qasjen e plotë ndërsa të përpunuara bëhen publike brenda institucionit. Stafi akademik në nënshkrimin e kontratës së punës pranë UMT, pranon të ruajë të dhënat sensitive me të cilat haset gjatë aktiviteti në UMT.

	Shënime në vizitë			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>NJSBC dhe GVB paraqesin raportet mbi gjetjet dhe vlerësimet si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Në përmbyllje të raporteve ka një analizë mbi pikat e forta dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimin e pikave të forta. Për pikat e dobëta dhe sugjerimeve dhe masat që mund të ndërmerren, mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore por edhe institucioni për ti përmirësuar ato në të ardhmen.</p> <p>Aneksi 38. raporti per metodat inovative ne procesin e mesimdhenies; Aneksi 55. Raporti vjetor i aktivitetit mesimor kerkimor dhe financiar.</p>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Sipas RVB, proceset e vlerësimit në kuadër të akreditimit të UMT si institucion apo si programe, kanë patur impakt në ndërgjegjësimin e të gjitha strukturave, personelit akademik dhe studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. GVJ konstaton që UMT çmon dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit në vlerësim.</p> <p>Shënime në vizitë</p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>Për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit MSH në Inxhinieri Informatike NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe fakulteteve. Takime kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale. Po ashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Grupin e Vetëvlersimit dhe NJSBC, çfarë u mundëson atyre që të përcjellin në mënyrë të vazhdueshme mendimet e tyre mbi problemet e cilësisë dhe të sugjerojnë masa që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të saj.</p> <p>Aneksi. 65. Anetaret e njesise se sigurimit te brendshem te cilesise; RVB: Shënimet e vizitave në UMT</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Metropolitan Tirana”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Stafi akademik rezulton i kualifikuar dhe kompetent në transmetimin e dijeve dhe njohurive tek studentët, duke i vlerësuar ata objektivisht, duke i orientuar ata drejt së dobishmes dhe duke i motivuar për përvetësim cilësor e të qëndrueshëm të njohurive.
2. Numër relativisht i lartë i marrëveshjeve institucionale si për aktivitetet didaktike ashtu edhe për projekte kërkimore-shkencore.
3. Pjesëmarrje në disa projekte ndërkombëtare dhe shkëmbime stafi për avancimin akademik.
4. Programi studimit Masteri Shkencave në “Inxhinieri Informatike” mbështetet në një plan mësimor të mirëstrukturuar dhe kompetitiv.
5. Përdorimi me efikasitet i platformave online në kuadër të zhvillimit të mësimin në distancë dhe risive teknologjike.

Pika të dobta

1. Zhvillimi i aktiviteteve didaktike në këtë program studimi realizohet në një masë të lartë nga personel akademik i ftuar/me kontratë;
2. Biblioteka ka kapacitet të ulët akomodues, fond jo te mjaftueshëm të librave në sasi dhe jo të viteve të fundit;
3. Literatura e detyruar e përdorur në lëndët e këtij program studimi nuk është e azhornuar në 5 vitet e fundit;
4. Rregullore të ndryshme të institucionit kanë mbivendosje duke tejkaluar kompetencat e thelbit të zbatimit të tyre dhe mund të bien në konflikt në rast modifikimi/azhornimi të njëjës cilado prej tyre.
5. Rregullarja e këtij programi studimi nuk është e plotë dhe ka nene që bien në kundërshtim me të dhëna që janë publike në faqen ueb apo dokumenta të tjera të institucionit për sa i përket pranimin të studentëve.

6. Kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi janë shumë të përgjithëshme duke mos garantuar një prurje cilësore dhe uniformitet njohurish paraprake të nevojshme për të ndjekur aktivitetet didaktike.

Rekomandime

1. Të përmiresohet raporti i mbulimit të ngarkesës mësimore PAE/PAK në vijimësi në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
2. Të rriten kapacitetet e bibliotekës në hapësira, infrastrukturë kompjuterike ashtu edhe në literaturë të viteve të fundit, sipas fushës së programit të studimit.
3. Të azhurnohen plan-programet e lëndëve me literaturë bashkëkohore të 5 viteve të fundit, sidomos për një program të tillë studimi;
4. Rregulloret të hartohen në mënyrë që të kenë një renditje hierarkike të kompetencave pa duplikuar nene dhe specifikime mes tyre.
5. Të rishikohet rregullorja e programit të studimit duke specifikuar kriteret, kushtet dhe procedurat për pranimin, transferimin, ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve. Nëse kriteret janë dinamike, të jepen anekse përkatëse dhe të specifikohen rregullat e modifikimit të tyre;
6. Të përkufizohen kriteret pranimi për studentët e këtij programi studimi me qëllim rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje.

Conclusions for the study program evaluation of the second cycle, Master of Science in "Information Engineering" for the Institution of Higher Education "Metropolitan Tirana"

Strengths and affirmations

1. The academic staff is qualified and competent in transmitting knowledge to the students, evaluating them objectively, orienting them towards usefulness and motivating them for quality and sustainable acquisition of knowledge.
2. Relatively high number of institutional agreements for both didactic activities and research projects.
3. Participation in several international projects and staff exchanges for academic advancement.
4. The study program, Master of Science in "Computer Engineering" is based on a well-structured and competitive curriculum.
5. Effective use of online platforms in the context of the development of distance learning and technological innovations.

Weaknesses

1. The development of didactic activities in this study program is realized to a large extent by invited contracted academic staff;
2. The library has a low accommodation capacity, insufficient stock of books in quantity and not of recent years;
3. Compulsory literature used in the subjects of this study program is not updated in the last 5 years;
4. Different regulations of the institution overlap by exceeding the core competencies of their implementation and may be in conflict in case of modification/updating of any of them.
5. The regularity of this study program is not complete and there are articles that contradict the data that are public on the website or other documents of the institution regarding the admission of students.
6. The criteria for admission of students in this study program are very general, not guaranteeing a quality input and uniformity of prior knowledge needed to attend didactic activities.

Recommendations

1. To improve the PAE/PWD teaching load coverage ratio on an ongoing basis in accordance with applicable legal acts.
2. To increase the capacity of the library in space, computer infrastructure as well as in literature of recent years, according to the field of study program.
3. To update the curricula of courses with contemporary literature of the last 5 years, especially for such a study program;
4. Regulations should be drafted in order to have a hierarchical order of competencies without duplicating articles and specifications between them.
5. Review the regulation of the study program specifying the criteria, conditions and procedures for admission, transfer, termination and resumption of studies. If the criteria are dynamic, provide relevant annexes and specify rules for their modification;
6. Define admission criteria for students of this study program in order to increase the quality of incoming students.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X